



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

RELACIONI I BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË TË VITIT 2026 DHE PBA 2026-2028

Dhjetor 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Përmbajtja e buxhetit vjetor 2026 dhe PBA 2026-2028

1.	Hyrje	4
2.	Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore	6
3.	Buxheti vendor 2026	7
4.	Buxhetimi gjinor	8
5.	Buxheti 2026	9
6.	Të ardhurat e veta të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	14
6.1.	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	14
6.2.	Të ardhurat nga institucionet e vartësisë	45
6.3.	Transferta e pakushtëzuar	45
6.4.	Transfertat e pakushtëzuara sektoriale	46
6.5.	Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore	48
7.	Buxheti i Bashkisë Korçë sipas dokumentave bazë dhe shoqërues	49
7.1.	Dokumentacioni bazë:	49
7.2.	Dokumentacioni shoqërues	65
8.	BUXHETI I BASHKISË KORÇË 2026	80
8.1.	Programi: Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi AA122	80
8.2.	Programi: Siguria publike AB 122	82
8.3.	Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik AC122	84
8.4.	Programi AJ122	94
	Fondi rezervë 04910	94
8.5.	Programi AK122	95
	Fondi i kontigjencës 04940	95
8.6.	Programi Mbrojtja e Mjedisit AD122	95
8.7.	Programi: Shërbime Publike Vendore AE122	96
8.8.	Programi: Arsimi Bazë dhe Parashkollor AG122	97
8.9.	Programi: Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm AH122	98
8.10.	Programi: Përkujdesi social AI122	99
9.	BUXHETI PËR INSTITUCIONET E VARËSISË PËR VITET 2026,	105
9.1.	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	105
9.2.	Klubi Shumësportësh	106
9.3.	Qendra e Artit dhe Kulturës	108
9.4.	Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes	110
9.5.	Qendra Ditore e Zhvillimit dhe Qendra e Zhvillimit Rezidencial	112
9.6.	Qendra e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes (ish Shtëpia e Foshnjës)	113



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

10. Projekt Buxheti Afatmesëm 2026-2028

113



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

1. Hyrje

Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2026 është më shumë se një dokument financiar: është një kontratë besimi me komunitetin tonë, një pasqyrim i ambicies, energjisë dhe synimeve të çdo banori të bashkisë. Ai ndërtohet mbi bindjen se zhvillimi nuk është vetëm investim në asete fizike, por krijim i mundësive të reja, rritje e mirëqenies dhe forcim i lidhjeve midis njerëzve që e quajnë këtë territor shtëpinë e tyre.

Ky buxhet pasqyron aspiratën tonë për të ndërtuar një bashki ku çdo nismë, shërbim dhe investim i drejtohet ndërtimit të një të ardhmeje më të mirë për qytetarët, duke u nisur nga nevojat reale të komunitetit dhe duke i shndërruar ato në politika të prekshme e të zbatueshme. Në vitin 2026, ky orientim merr një formë edhe më të qartë: e vendosim zhvillimin ekonomik në krye të prioritetëve tona, sepse ai krijon punësim, rrit të ardhurat lokale dhe i jep qëndrueshmëri çdo investimi publik.

Zhvillimi ekonomik mbështetet në katër shtylla që lidhen natyrshëm mes tyre: turizmin, bujqësinë, inovacionin dhe edukimin. Në turizëm, synimi ynë nuk është vetëm rritja e numrit të vizitorëve, por edhe rritja e ditëve të qëndrimit, në mënyrë që Korça të mos jetë thjesht një ndalesë, por një destinacion ku vizitori qëndron më gjatë, përjeton më shumë dhe rikthehet. Kjo do të realizohet përmes përmirësimit të përvojës turistike gjatë gjithë vitit, forcimit të kalendarit të aktiviteteve, krijimit të itinerareve tematike, promovimit të produkteve lokale dhe bashkëpunimit të ngushtë me biznesin e turizmit.

Paralelisht, bujqësia mbetet një nga asetet më të çmuara të territorit tonë dhe një burim i rëndësishëm i të ardhurave për shumë familje. Politikat tona synojnë të rrisin produktivitetin, cilësinë dhe aksesin në treg, duke e parë zhvillimin bujqësor të lidhur ngushtë me nevojat e pjesës rurale të bashkisë. Fshatrat nuk janë periferi, por pjesë thelbësore e zhvillimit; ndaj, krahas mbështetjes për fermerët dhe nxitjes së prodhimit vendor, do të përmirësojmë infrastrukturën që u shërben komuniteteve rurale dhe lidhjen e tyre me qendrën dhe tregjet.

Teknologjia dhe inovacioni janë porta jonë drejt së ardhmes dhe një mënyrë konkrete për të krijuar mundësi të reja, veçanërisht për të rinjtë. Në 2026, do të vijojmë të nxisim zgjidhje të digjitalizuara, shërbime të zgjuara dhe iniciativa sipërmarrëse që i japin Korçës një profil modern, rrisin efikasitetin e administrimit dhe e bëjnë bashkinë më tërheqëse për ide, projekte dhe investime.

Edukimi, si shtylla themelore e çdo transformimi, lidhet drejtpërdrejt me inovacionin dhe zhvillimin ekonomik. Në 2026, ambicia jonë për Korçën si qytet universitar dhe qendër e formimit cilësor do të përkthehet në masa që përmirësojnë infrastrukturën dhe cilësinë e arsimit, zgjerojnë hapësirat ku talentet e reja rriten dhe afirmohen, si edhe mbështesin rihapjen e Liceut Francez si një hap i rëndësishëm për arsimin elitare dhe orientimin drejt aftësive moderne.

Pas zhvillimit ekonomik, prioriteti i dytë i buxhetit 2026 është infrastruktura, sepse ajo është baza e shërbimeve të mira dhe e një jete më cilësore. Investimet do të fokusohen në përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe rurale: rrugë më të sigurta, ndriçim më të mirë, hapësira të gjelbra dhe ambiente komunitare, si edhe ndërhyrje që rrisin funksionalitetin e shërbimeve bazë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet infrastrukturës që i shërben zonave rurale, duke e parë atë si kusht për zhvillimin bujqësor, turizmin rural dhe aksesin e barabartë në shërbime.

Në të njëjtën kohë, buxheti ruan një fokus të fortë tek shërbimet sociale, për të garantuar mbështetje për të moshuarit, fëmijët, familjet në nevojë dhe çdo grup që kërkon kujdes të shtuar. Ne synojmë që askush të mos mbetet i përjashtuar dhe që çdo banor të ndiejë se Bashkia Korçë është pranë tij, e vëmendshme dhe e përgjegjshme ndaj sfidave të përditshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Arti dhe kultura janë zemra e identitetit korçar dhe një motor i vërtetë zhvillimi që forcon ekonominë lokale, rrit tërheqjen turistike dhe ruan shpirtin e këtij territori. Në 2026, do të vijojmë të mbështesim aktivitetet dhe institucionet kulturore si pjesë e cilësisë së jetës, e edukimit qytetar dhe e promovimit të Korçës brenda dhe jashtë vendit.

Sporti do të ketë një vëmendje të veçantë në vitin 2026, kur Korça mban titullin “Qyteti Europian i Sportit 2026”. Ky status do të shoqërohet me aktivitete që rrisin pjesëmarrjen, promovojnë një stil jetese të shëndetshëm dhe forcojnë imazhin e qytetit, duke e bërë sportin një element të përditshëm të komunitetit dhe një pjesë të rëndësishme të kalendarit qytetar.

Të gjitha këto drejtime ndërthuren në një buxhet të hartuar me transparencë, përgjegjshmëri dhe vizion të qartë, me qëllimin për të rritur mirëqenien e çdo familjeje, për të mbështetur sipërmarrjen, për të krijuar mundësi të reja punësimi dhe për të forcuar kohezionin social. Me përkushtim dhe dashuri për bashkinë tonë, vijojmë rrugën drejt një Korçe më të zhvilluar, më dinamike dhe më të aftë për të përballuar sfidat e kohës.

Kryetari i Bashkisë
SOTIRAQ FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

1. Kuadri ligjor

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore;
- Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
- Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për “Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.
- Ligje, VKM dhe akte nënligjore të tjera.

2. Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
2. Funksionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.
4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
5. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

- Parimi i autonomisë vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtën dhe aftësinë të rregullojnë dhe të administrojnë në mënyrë të pavarur një pjesë të rëndësishme të punëve publike, në përputhje me ligjin.

-Parimi i autonomisë financiare

Njësitë vendore kanë të drejtë të kenë **burime financiare të veta**, të menaxhojnë buxhetin dhe të përcaktojnë politika të veta fiskale brenda kufijve ligjorë.

-Parimi i transparencës dhe llogaridhënies



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Organet vendore duhet të veprojnë në mënyrë **të hapur, transparente dhe të përgjegjshme** ndaj qytetarëve.

- Parimi i pjesëmarrjes së qytetarëve

Qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në çështjet e qeverisjes vendore.

-Parimi i paanësisë dhe barazisë

Shërbimet vendore duhet të ofrohen pa diskriminim, duke garantuar **trajtim të barabartë** të qytetarëve.

3. Buxheti vendor 2026

Reformat e zhvilluara ndër vite për modernizimin e financave vendore kanë dhënë rezultate në përmirësimin e treguesve fiskalë, në konsolidimin financiar dhe në përmirësimin metodologjik të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit. Financat e qeverisjes vendore do të modernizohen, me qëllim përballimin e sfidave të zhvillimit dhe përputhjen me direktivat e pranimi të Shqipërisë si anëtare e Bashkimit Evropian, si dhe do të shndërrohen në një instrument kryesor për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët, duke garantuar efikasitet, ekonomi dhe efikasitet. Konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhdimin të zbatimit të procesit të decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në drejtim të përmirësimit të administrimit fiskal vendor, fokusi do të jetë në rritjen e ndjeshme të të ardhurave përmes reformimit dhe harmonizimit të sistemit fiskal vendor, duke shfrytëzuar në maksimum kapacitetet fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Kjo do të shoqërohet edhe me përmirësimin e administrimit fiskal vendor përmes digjitalizimit të mbledhjes së taksave dhe tarifave, zgjerimit të bazës tatimore dhe forcimit të kapaciteteve profesionale të administratës vendore.

Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore janë:

- Forcimi i sistemeve të menaxhimit të financave publike dhe të informacionit financiar, nëpërmjet reformimit të sistemit buxhetor duke e bërë atë instrumentin kryesor të mirëmenaxhimit të shërbimeve publike për komunitetet vendore;
- Mbështetja financiare e NJVQV-ve përmes rritjes së transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si formë për të siguruar dhe rritur standardin e shërbimeve publike;
- Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor, një tregues i rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike;
- Rritja e nivelit të pagave për pushtetin vendor, me një mbështetje buxhetore për mbulimin e efekteve financiare shtesë si rezultat i rritjes së kufirit minimal.
- Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale dhe Taksës së Rentës Minerare duke i dhënë mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të rritur efektshmërinë në ofrimin e shërbimeve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- Zbatimi i metodologjisë së re për hartimin e PBA në nivel produkti; Monitorimi i pilotimit të bashkive në përgatitjen e buxhetit me një numër të reduktuar programesh dhe detajimin deri në nivel produkti;
- Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;
- Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor “Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore, në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm, por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme me njvqjv-të në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.

4. Buxhetimi gjinor

Të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore. Të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore; Barazia gjinore, që i referohet gjendjes së burrave dhe grave që kanë mundësi dhe akses të barabartë në të njëjtat të drejta dhe përfitime.

Gjatë vitit 2025 u miratua plani vendor i veprimit për barazinë gjinore 2025-2030

Një nga objektivat e Bashkisë Korçë është: Garantimi i funksionimit të një sistemi cilësor të shërbimeve të kujdesit shoqëror për një shërbim pa asnjë lloj diskriminimi duke respektuar të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.

Fushat kryesore të ndërhyrjes

PVVBJ 2025 - 2030 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të rejtat, në të gjithë diversitetin e tyre.
- III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.
- IV. Integrimi gjinor në politikat vendore. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.

Në buxhetin e vitit 2026 janë planifikuar aktivitetet sipas PVVBGJ 2025 – 2030, të cilat shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, si dhe kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta.

5. Buxheti 2026

Ky buxhet është hartuar në përputhje me objektivat e Bashkisë, si dhe është bazuar në realizimin 10 mujor të të ardhurave dhe shpenzimeve, në realizimin e pritshëm të vitit 2025, në nevojat për fonde për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, në kërkesat për shpenzime sipas institucioneve, si dhe nga konsultimet e buxhetimit me pjesmarrje. Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2026 do të jetë **2,614,473 mijë lekë**, i planifikuar sipas 11 programeve, të cilat përfshijnë 26 funksione që menaxhohen nga Bashkia dhe Institucionet e Varësisë.

Buxheti sipas llogarive ekonomike

Shpenzime për personelin	1,284,545 mijë lekë
Shpenzime korrente	960,314 mijë lekë
Shpenzime për investime	369,614 mijë lekë

Total **2,614,473 mijë lekë**

Në formë tabelore sipas llogarive ekonomike dhe për vitet 2024-2028 paraqitet si më poshtë:
000/lekë

Emertimi i shp	PI 2024F	PI 2024nd	PI 2025	PI 2025 nd	PI 26 sipas PBA 26-28	Realizimi 11m	PI I real te pr 2025	PI 2026	PI 2027	PI 2028	Dif 26-25F	% e rritjes	Dif 26-26 sipas PBA 26-28	% e rritjes	pesha specifike ne %
Shp personeli	935,197	979,717	1,157,767	1,159,954	1,195,650	953,171	1,045,126	1,284,545	1,297,627	1,310,779	126,778	111%	88,895	107%	49%
Shp korrente	1,048,464	1,122,366	1,016,552	1,100,749	1,022,718	703,917	868,664	960,314	977,757	982,227	(56,238)	94%	(62,404)	94%	37%
Shp per investime	269,609	431,810	303,699	415,520	302,300	90,551	190,342	369,614	380,691	412,320	65,915	122%	67,314	122%	14%
Total	2,253,270	2,533,893	2,478,018	2,676,223	2,520,668	1,747,639	2,104,132	2,614,473	2,656,075	2,705,326	136,455	106%	93,805	104%	100%

Analiza e shpenzimeve buxhetore për periudhën 2024–2028 tregon një rritje të qëndrueshme të buxhetit total, me theks të veçantë në shpenzimet për personelin dhe investimet, ndërkohë që shpenzimet korrente mbahen nën kontroll.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 122 - Bashkia Korçë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	814,377	902,304	1,157,767	1,159,954	1,284,545	1,297,627	1,310,779
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	697,713	773,218	991,373	993,262	1,100,382	1,111,678	1,122,981
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	116,664	129,086	166,394	166,693	184,164	185,949	187,798
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	720,510	842,499	1,016,552	1,089,478	960,314	977,756	982,227
602	Mallra dhe sherbime te tjera	541,484	653,419	815,956	860,598	770,187	788,325	793,662
603	Subvencionet	10,626	10,201	10,700	10,700	10,200	10,200	10,200
604	Transferime korrente te brendeshme	110,710	126,827	149,370	173,207	147,382	147,720	148,020
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	17,239	15,982	10,225	14,973	10,345	10,345	10,345
609	Rezervat	0	0	20,000	19,700	20,000	20,000	20,000
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	2,828	35,202	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	37,623	868	10,300	10,300	2,200	1,166	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	162,892	190,802	242,999	344,728	308,913	319,991	351,620
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrushme te patrupezuara	779	3,087	12,500	14,288	15,900	17,000	18,000
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrushme te trupezuara	162,113	187,715	230,499	330,440	293,013	302,991	333,620
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0	0	0	0
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	0	0	0	0	0	0	0
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0	7,875	0	0	0
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	0	0	7,875	0	0	0
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0

Dokumenti Përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 - Miratuar nga Këshilli i NJVQV (Faza III).

Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 122 - Bashkia Korçë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	60,700	69,818	60,700	60,700	60,700
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrushme te patrupezuara	0	0	60,700	60,700	60,700	60,700	60,700
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrushme te trupezuara	0	0	0	9,118	0	0	0
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	1,697,779	1,935,605	2,478,018	2,671,854	2,614,473	2,656,075	2,705,326

Dokumenti Përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 - Miratuar nga Këshilli i NJVQV (Faza III).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Në vitin 2026, shpenzimet totale arrijnë në 2,614,473 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 136,455 mijë lekë krahasuar me planin fillestar të vitit 2025, ose 106%. Krahasuar me parashikimin sipas PBA 2026–2028, shpenzimet totale janë më të larta me 93,805 mijë lekë, që përfaqëson një rritje prej 104%.

Shpenzimet për personelin përbëjnë zërin kryesor të buxhetit, me një peshë specifike prej 49% të totalit. Në vitin 2026, këto shpenzime arrijnë në 1,284,545 mijë lekë, duke u rritur me 126,778 mijë lekë krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2025 (111%) dhe me 88,895 mijë lekë krahasuar me planin sipas PBA 2026–2028 (107%). Kjo rritje reflekton nevojën për mbështetje të kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimin e strukturës së pagave. Rritja vjen nga llogaritja e pagës minimale e cila shkon nga 40,000 lekë në 50,000 lekë. Rritja e shpenzimeve në shpenzimet e personelit do të përballohet nga fondi i transfertës së pakushtëzuar për rritjen e pagave, nga transfertat e pakushtëzuar, nga fondi i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për funksionet që mbulohen nga Bashkia, si dhe nga të ardhurat e Bashkisë. Ky fond është planifikuar për 1,239 punonjës.

Shpenzimet korrente, ku përfshihet pagesa për shpenzime operative, mirëmbajtje, shërbimi i pastrimit, subvencioni për shërbimin urban, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe e dëshmorëve, aktivitetet turistike, kulturore, materiale ndërtimi për infrastrukturën rrugore, transfertat tek organizatat, transfertat tek individët dhe pagesa për principalin, zënë 37% të buxhetit total. Për vitin 2026 ato parashikohen në 960,314 mijë lekë, duke shënuar një ulje prej 56,238 mijë lekë krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2025 (94%) dhe një ulje prej 62,404 mijë lekë krahasuar me parashikimin sipas PBA 2026–2028 (94%). Kjo tendencë tregon një menaxhim më eficient të shpenzimeve operative. Kjo ulje vjen për shkak të planifikimit të shpenzimeve sipas nevojave, kontratave për disa shërbime, nga ulja e pagesës së kredisë, si dhe ulja e disa shpenzimeve operative.

Shpenzimet për investime përfshihen investime në infrastrukturën rrugore, shkolla, paisje të ndryshme, investime në pyje dhe kullota, etj përbëjnë 14% të buxhetit total dhe paraqesin rritjen më të lartë në terma relativë. Për vitin 2026, ato arrijnë në 369,614 mijë lekë, duke u rritur me 65,915 mijë lekë krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2025 (122%) dhe me 67,314 mijë lekë krahasuar me parashikimin sipas PBA 2026–2028 (122%). Kjo rritje synon mbështetjen e projekteve zhvillimore dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Në perspektivën afatmesme, shpenzimet totale vijnë një trend rritës, duke arritur në 2,656,075 mijë lekë në vitin 2027 dhe 2,705,326 mijë lekë në vitin 2028. Rritja progresive e investimeve dhe stabiliteti i shpenzimeve korrente krijojnë një strukturë buxhetore më të balancuar dhe të qëndrueshme.

Në përfundim, struktura e shpenzimeve për periudhën 2024–2028 reflekton një orientim drejt forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe rritjes së investimeve, duke ruajtur disiplinën fiskale në shpenzimet korrente dhe duke siguruar stabilitet buxhetor afatmesëm.

Informacioni sipas llogarive ekonomike të vitit 2026 dhe viteve 2027 – 2028 sipas PBA 2026-2028 faza e II-të dhe sipas fazës përfundimtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

000/lekë

		ishte	bëhet	ishte	bëhet	ishte	bëhet
Emertimi i shp	PI 26	PI 2026 sipas PBA 2026-2028	PI 2026 sipas PBA 2026-2029	PL 2027 sipas PBA 2026-2028	PL 2027 sipas PBA 2026-2028	PL 2028 sipas PBA 2026-2028	PL 2028 sipas PBA 2026-2028
Shp personeli	1,284,545	1,195,650	1,284,545	1,235,611	1,297,627	1,279,099	1,310,779
Shp korrente	960,314	1,022,718	960,314	1,027,053	977,756	1,028,834	982,227
Shp per investime	369,614	302,300	369,614	303,280	380,691	303,823	412,320
Total	2,614,473	2,520,668	2,614,473	2,565,944	2,656,075	2,611,756	2,705,326

BUXHETI SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT:

Tabela 1: Burimet e financimit (vlerat në 000/lekë)

Burimet	Buxheti fillestar 2025	Buxheti 2025 I ndryshuar	PI I realizimit te pritshem 2025	Buxheti fillestar 2026	Dif PI26-PI25 fillestar	Pesha specifike e burimeve ne %
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	1,201,986	1,202,229	813,060	1,209,185	7,199	46.2%
Të ardhurat e institucioneve	35,960	35,960	19,567	42,275	6,315	1.6%
Transferta e pakushtëzuar	628,561	628,561	628,561	665,252	36,691	25.4%
Transferrat e pakushtëzuara sektoriale	447,317	450,572	450,572	500,332	53,015	19.1%
Transferta e pakushtëzuar per rritjen e pagave	95,494	95,494	95,494	128,979	33,485	4.9%
Transferrat e pakushtëzuara sektoriale per menaxhimin e mbetieve urbane	8,000	8,000	8,000	7,600	-400	0.3%
Të ardhurat e trashëguara		167,213	168,413		0	0.0%
Fondet IPA	60,700	60,700		60,700	0	2.3%
Sponsorizime		4,370	4,370		0	
Të tjera		23,124	6,131	150	150	0%
Total	2,478,018	2,676,223	2,194,168	2,614,473	136,455	100%

Analiza e burimeve të financimit tregon se buxheti i vitit 2026 mbështetet kryesisht në të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe në transferrat nga buxheti i shtetit, duke ruajtur një strukturë relativisht të qëndrueshme krahasuar me vitin 2025.

Buxheti fillestar për vitin 2026 parashikohet në vlerën 2,614,473 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 136,455 mijë lekë krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2025. Kjo rritje përfaqëson një zgjerim të moderuar të kapaciteteve financiare të njësisë vendore.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026 parashikohen në masën 1,209,185 mijë lekë, me një rritje prej 7,199 mijë lekë krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2025. Ky zë përbën burimin kryesor të financimit, me një peshë specifike prej 46.2% të totalit të buxhetit, duke reflektuar rëndësinë e të ardhurave të veta në financimin e shpenzimeve vendore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Të ardhurat e institucioneve parashikohen në vlerën 42,275 mijë lekë për vitin 2026, duke shënuar një rritje prej 6,315 mijë lekë krahasuar me vlerën fillestare të vitit 2025. Megjithatë, pesha e tyre në totalin e burimeve mbetet e kufizuar, në nivelin 1.6%.

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit për vitin 2026 parashikohet në masën 665,252 mijë lekë, me një rritje prej 36,691 mijë lekë krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2025. Ky burim përbën 25.4% të totalit të buxhetit dhe mbetet një komponent i rëndësishëm për mbështetjen e funksioneve bazë të njësisë vendore.

Transferrat e pakushtëzuara sektoriale arrijnë në 500,332 mijë lekë në vitin 2026, duke u rritur me 53,015 mijë lekë krahasuar me vlerën fillestare të vitit 2025. Ato zënë 19.1% të totalit të burimeve dhe lidhen kryesisht me financimin e funksioneve të deleguara dhe shërbimeve sektoriale.

Transferta e pakushtëzuar për rritjen e pagave parashikohet në vlerën 128,979 mijë lekë për vitin 2026, me një rritje prej 33,485 mijë lekë krahasuar me vitin 2025. Ky zë përbën 4.9% të totalit dhe mbështet zbatimin e politikave të rritjes së pagave në administratën vendore.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për menaxhimin e mbetjeve urbane parashikohet në vlerën 7,600 mijë lekë për vitin 2026, duke shënuar një ulje prej 400 krahasuar me vitin 2025, me një peshë specifike prej 0.3%.

Fondet IPA për vitin 2026 mbeten në të njëjtin nivel me vitin 2025, në vlerën 60,700 mijë lekë, dhe përbëjnë 2.3% të totalit të burimeve.

Ndërkohë, të ardhurat e trashëguara nuk parashikohen në buxhetin fillestar të vitit 2026, ndërsa zëri “të tjera” paraqitet me vlera minimale dhe pa ndikim të ndjeshëm në strukturën e buxhetit.

Burimet e financimit për vitin 2026 tregojnë një varësi të konsiderueshme nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit, ndërkohë që diversifikimi i burimeve mbetet i kufizuar. Rritja e moderuar e buxhetit krijon hapësira për përmbushjen e prioriteteve të njësisë vendore duke ruajtur stabilitetin financiar.

Informacioni sipas burimeve të financimit të vitit 2026 dhe viteve 2027 – 2028 sipas PBA 2026-2028 faza e II-të dhe sipas fazës përfundimtare.

000/lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

		ishte	bëhet	ishte	bëhet	Ishte	bëhet
Burimet	PI 2026	PI 2026 sipas PBA 2026-2028	PI 2026 sipas PBA 2026-2029	PL 2027 sipas PBA 2026-2028	PL 2027 sipas PBA 2026-2028	PL 2028 sipas PBA 2026-2028	PL 2028 sipas PBA 2026-2028
Transferta e pakushtëzuar	665,252	661,632	665,252	697,232	701,263	733,273	740,742
Transferta për rritjen e pagave	128,979	95,494	128,979	95,494	128,979	95,494	128,979
Transferta për menaxhimin e mbetjeve	7,600	8,000	7,600	8,000	7,600	8,000	7,600
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	500,332	447,317	500,332	447,317	500,332	447,317	500,332
Te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore+te ardhurat e Institucioneve	1,251,460	1,247,525	1,251,460	1,257,201	1,257,201	1,266,972	1,266,972
Fondet IPA	60,700	60,700	60,700	60,700	60,700	60,700	60,700
Te ardhurat te tjera	150		150				
Total	2,614,473	2,520,668	2,614,473	2,565,944	2,656,075	2,611,756	2,705,325

Informacioni më i detajuar i burimeve paraqitet përgjatë materialit.

6. Të ardhurat e veta të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

6.1. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE NGA BURIMET E VETA PËR VITIN 2026

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta vendore për vitin 2026 bazohet në analizën e legjislacionit fiskal në fuqi, performancën historike të arkëtimeve dhe kapacitetet aktuale administruese të Bashkisë Korçë. Në këtë proces janë marrë në konsideratë taksat vendore, tarifat vendore, taksat e ndara dhe të gjitha të ardhurat e mbledhura nga drejtoritë dhe institucionet përgjegjëse, ashtu si edhe detyrimet debitore të viteve paraardhëse.

Llogaritja e të ardhurave për vitin 2026 është mbështetur në paketën fiskale të miratuar nga Këshilli i Bashkisë Korçë, Vendimi nr.119, datë 27.11.2025 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2026”, si dhe në një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore që rregullojnë administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Ky kuadër përcakton nivelin e taksave, bazën e taksueshme, kategoritë e taksapaguesve, mënyrën e llogaritjes dhe procedurat e mbledhjes së të ardhurave.

Nëpërmjet këtyre akteve, Bashkia siguron uniformitet në procedurat e administrimit, transparencë në llogaritje dhe harmonizim me politikat kombëtare të financave vendore.

Planifikimi për vitin 2026 është ndërtuar mbi disa shtylla kryesore:

- **Zbatimi i niveleve fiskale të miratuara** për vitin 2026 dhe ndikimi real i tyre në bazën e taksapaguesve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- **Analiza e performancës historike**, duke krahasuar realizimet e vitit 2023, realizimet e vitit 2024, planifikimin e vitit 2025 dhe realizimin 11-mujor të vitit 2025.
- **Përmirësimi i kapaciteteve administrative**, sidomos në proceset e identifikimit të bazës së taksueshme, ndjekjes së detyrimeve të prapambetura dhe rritjes së efikasitetit në komunikimin me taksapaguesit.
- **Zgjerimi i bazës së taksapaguesve**, si rezultat i saktësimit të të dhënave, rikategorizimeve, legalizimeve të pronave dhe përmirësimit të regjistrave.
- **Rritja e kontrollit mbi agjentët tatimorë**, të cilët administrojnë dhe mbledhin një pjesë të të ardhurave për llogari të Bashkisë.

Performanca e të ardhurave nga burimet e veta në vitet e fundit ka qenë në përmirësim të qëndrueshëm, falë:

- konsolidimit të regjistrave të taksapaguesve,
- rritjes së nivelit të deklarimit dhe transparencës,
- lehtësimit të procedurave për familjet dhe bizneset,
- forcimit të mekanizmave të kontrollit,
- zbatimi dhe ndjekja e masave shtrënguese,

Rritja e të ardhurave nuk është rezultat i rritjes së barrës fiskale, por kryesisht i **zgjerimit të bazës, formalizimit të subjekteve**, dhe **saktësimit të të dhënave** për pasuritë e paluajtëshme dhe aktivitetet ekonomike.

Një rol të rëndësishëm në dinamikën e të ardhurave luan edhe **mbledhja e detyrimeve debitore**, ku Bashkia aplikon të gjitha procedurat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera për garantimin e mbledhjes efektive dhe uljen e stokut të borxhit tatimor. Gjithashtu “Paqja Fiskale”, si një nismë e qeverisë që parashikon faljen e detyrimeve të caktuara dhe lehtësimin e procedurave për shlyerjen e borxheve tatimore të akumuluar ndër vite, pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e të ardhurave që do të realizohen gjatë vitit 2026 nga detyrimet e prapambetura. Kjo nismë, ndonëse synon rritjen e formalizimit dhe uljen e barrës administrative për tatimpaguesit, pritet të sjellë reduktim të një pjese të të ardhurave potenciale nga mbledhja e detyrimeve të vjetra, duke ndikuar në mënyrë të moderuar në performancën totale të arkëtimeve.

Në vitin 2026 pritet një **rritje e moderuar, por e qëndrueshme**, e arkëtimeve nga taksat vendore dhe tarifatat, kryesisht nga:

- rritja e numrit të subjekteve të reja ekonomike
- përmirësimi i sistemit të informacionit, komunikimit dhe dixhitalizimit të shërbimeve
- rritja e efikasitetit të strukturave të administrimit tatimor dhe agjentëve mbledhës

Të gjitha drejtoritë dhe institucionet e Bashkisë, si dhe agjentët tatimorë, janë pjesë përbërëse e sistemit të mbledhjes së të ardhurave. Angazhimi i tyre siguron rakordimin, monitorimin dhe raportimin e saktë të rezultateve.

Puna e këtyre strukturave ka kontribuar në:



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

- rritjen e transparencës me taksapaguesit
- saktësimin e të dhënave për pasurinë e paluajtëshme dhe aktivitetet ekonomike
- ndërgjegjësimin e familjeve dhe bizneseve për detyrimet e tyre financiare ndaj Bashkisë
- përmirësimin e klimës së bashkëpunimit

Në vijimësi të punës së kryer deri më tani, planifikimi për vitin 2026 synon:

- të garantojë një buxhet realist, të qëndrueshëm dhe të mbështetur në analiza të detajuara
- të rrisë eficiencën e mbledhjes së të ardhurave
- të ulë detyrimet e prapambetura
- të nxisë politika të qarta dhe të kuptueshme për taksapaguesit
- të krijojë kushte për një administrim modern dhe të dixhitalizuar të taksave dhe tarifave vendore

Në vijim paraqitet tabela e realizimeve faktike për vitet 2023 – Nëntor 2025, pritshmëritë e vitit 2025 dhe planifikimi për vitin 2026, për çdo taksë dhe tarifë të administruar nga Bashkia Korçë.

Në lekë

A	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	Realizim 2023	Realizim 2024	Plani 2025	Realiz.11 muaj 2025	I pritshëm 2025	Plani 2026
1	TAKSË MBI NDËRTESEN	117,967,686	131,333,113	198,377,195	146,260,481	155,260,481	197,708,144
2	TAKSË MBI TRUALLIN	12,725,319	19,967,113	28,470,679	13,948,224	14,448,224	26,042,660
3	TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE	22,155,006	26,431,706	57,859,514	22,737,627	24,937,627	53,311,030
4	TAKSË PËR NDËRTIMET E REJA	114,985,138	78,544,275	280,000,000	83,287,414	89,522,918	280,000,000
5	TAKSË NDIKIMI NË INFRASTRUKURË NGA LEGALIZIMET	10,743,943	6,726,891	28,000,000	7,026,557	7,412,851	20,085,288
6	TAKSË FJETJE NË HOTEL	7,376,395	8,900,552	9,000,000	9,248,275	9,948,275	10,792,470
7	TAKSË TABELË	7,529,513	8,334,772	12,027,109	8,815,093	10,615,093	11,936,388
	TOTALI A	293,483,000	280,238,422	613,734,497	291,323,671	312,145,469	599,875,980
B	TË ARDHURA JO TATIMORE						
1	TARIFË PASTRIMI	155,899,754	166,159,371	194,856,576	161,058,960	171,763,984	198,607,826
2	TARIFË NDRIÇIMI	35,904,083	47,785,556	59,919,515	48,567,649	51,553,062	62,570,169
3	TARIFË GJELBËRIMI	22,503,572	30,878,675	38,277,978	31,641,133	33,542,774	39,736,214
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE	12,436,440	13,834,616	16,792,970	12,655,874	13,806,827	17,199,638
5	TARIFË ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE	21,073,198	21,722,880	28,861,347	17,966,331	19,510,291	24,528,140
6	TARIFË SERVITUTI	697,334	806,101	547,848	851,195	851,195	1,087,107
7	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	1,094,405	1,476,350	1,555,000	1,268,520	1,338,520	1,610,000
8	TARIFË MUR PERIMETRAL	930,840	758,895	2,000,000	704,604	872,604	3,000,000
9	TARIFË PARKIMI	18,738,137	19,522,111	23,969,902	17,409,020	18,709,020	23,539,060
10	TE ARDHURA TE TJERA	14,590,532	11,578,489	23,562,425	24,258,149	25,639,235	6,199,384
11	ÇERTIFIKATË PËR	468,000	530,250	510,000	502,000	515,000	1,130,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

	MBROJTJEN NGA ZJARRI						
12	MIRATIM PROJEKTI	1,167,000	965,000	1,000,000	1,080,000	1,110,000	1,000,000
13	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA	-	-	30,000	-	-	10,000
14	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETEVE	-	-	40,000	-	-	340,000
15	MARRJE ME QERA PYLLI+ QERA PER KULLOTA	7,323,335	5,660,751	8,312,400	6,096,788	6,176,788	9,500,000
16	GJOBA MZSH	-	-	-	-	-	100,000
17	TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT	-	-	100,000	-	-	100,000
18	VËRTETIME TRANSPORTI	29,400	30,000	30,000	21,200	23,000	30,000
19	PRODHIMET E DYTA MIDICINALE	-	-	1,000,000	-	-	1,000,000
20	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	181,000	346,000	2,000,000	570,400	613,400	1,678,000
21	GJOBA PËR VONESE NË PAGESE	5,789,162	7,116,472	8,540,500	8,065,594	8,765,594	12,488,506
22	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	2,813,804	1,572,862	2,500,000	1,736,343	1,744,495	4,136,010
23	GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	70,000	40,000	100,000	40,000	80,000	100,000
24	GJOBA TË D.T.T.V	120,000	180,000	220,000	140,000	180,000	200,000
25	QIRA OBJEKTI,QERA TRUALI,QERA T.BUJQËSORE	10,426,524	9,612,474	11,756,222	8,473,101	9,485,226	17,894,150
26	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	640,000	450,000	1,000,000	500,000	510,000	1,200,000
27	TARIFE PËR LEJE NDËRTIMI	325,200	258,000	700,000	212,500	227,500	750,000
28	TË ARDHURA NGA QIRATË, BANESA SOCIALE (CEB)	6,879,735	8,133,349	8,513,088	7,560,574	8,601,845	8,596,908
29	TË ARDHURA NGA BANESA SHTETËRORE	92,886	102,333	72,000	69,259	45,900	54,000
30	QIRA NGA BANESAT NË PRONËSI TË BASHKISË E.K.B + PRIVATIZIMI I BANESAVE	168,464	96,000	524,000	88,000	96,000	188,000
31	PRIVATIZIM BANESE	8,099,635	2,679,024	2,613,180	2,457,770	2,652,671	2,038,158
32	KAMATË VONESA(QIRA OBJEKTI)	295,019	232,542	180,000	308,827	355,457	300,000
33	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	3,018,608	1,092,786	3,500,000	1,501,476	2,001,476	5,100,000
34	TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SISTEMIT KULLUES	9,248,941	10,819,688	29,266,429	10,584,629	11,534,503	27,997,375
	TOTALI B	341,025,006	364,440,574	472,851,380	366,389,896	392,306,367	474,008,645
C	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA						
1	TATIM SHITJEJE PASURI E PALUAJTSHME	6,197,114	7,634,433	15,000,000	12,689,009	13,566,279	26,000,000
2	TAKSË RREGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	46,259,021	51,043,386	55,000,000	49,986,487	54,026,811	60,000,000
3	RENTA MINERARE	492,865	275,079	400,000	169,570	180,751	300,000
4	TATIMI MBI TË ARDHURAT	31,840,118	35,574,204	45,000,000	32,834,373	40,834,373	49,000,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

	PERSONALE						
	TOTALI C	84,789,118	94,527,102	115,400,000	95,679,439	108,608,214	135,300,000
	TOTALI A+B+C	719,297,125	739,206,098	1,201,985,877	753,393,006	813,060,050	1,209,184,625



TAKSAT VENDORE

Taksat vendore zenë 49.6 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen gjatë vitit 2026

Në lekë

A	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	Realizim 2023	Realizim 2024	Plani 2025	Realiz.11mu aj 2025	I pritshëm 2025	Plani 2026
1	TAKSË MBI NDËRTESEN	117,967,686	131,333,113	198,377,195	146,260,481	155,260,481	197,708,144
2	TAKSË MBI TRUALLIN	12,725,319	19,967,113	28,470,679	13,948,224	14,448,224	26,042,660
3	TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE	22,155,006	26,431,706	57,859,514	22,737,627	24,937,627	53,311,030
4	TAKSË PËR NDËRTIMET E REJA	114,985,138	78,544,275	280,000,000	83,287,414	89,522,918	280,000,000
5	TAKSË NDIKIMI NË INFRASTRUKURË NGA LEGALIZIMET	10,743,943	6,726,891	28,000,000	7,026,557	7,412,851	20,085,288
6	TAKSË FJETJE NË HOTEL	7,376,395	8,900,552	9,000,000	9,248,275	9,948,275	10,792,470
7	TAKSË TABELË	7,529,513	8,334,772	12,027,109	8,815,093	10,615,093	11,936,388
	TOTALI A	293,483,000	280,238,422	613,734,497	291,323,671	312,145,469	599,875,980

Struktura e të ardhurave nga taksat vendore tregon qartë se disa zëra fiskalë mbajnë peshën kryesore në financimin e buxhetit vendor. Nga analiza rezulton se disa taksa mbeten burime kryesore financimi, ndërsa të tjerat kanë peshë më të moderuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Taksa mbi Ndërtesën, e cila përbën **16.4% të totalit të të ardhurave të planifikuara** dhe **33 % të të ardhurave nga taksat vendore**, duke u shfaqur si një burim i qëndrueshëm dhe me kontribut të lartë në buxhet.



Në të njëjtën linjë, **Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja** zë një peshë të konsiderueshme, duke kontribuar me **23.2% të totalit të të ardhurave** dhe me **46.7% të totalit të të ardhurave nga taksat vendore**. Ky tregues reflekton dinamizmin në sektorin e ndërtimit dhe rolin që ky aktivitet ka në financat vendore.

Zërat e tjerë mbajnë peshë më të moderuar, por gjithsesi të rëndësishme për diversifikimin e të ardhurave.

Taksa mbi Tokën Bujqësore përfaqëson **4.4% të totalit të të ardhurave** dhe **8.9% të të ardhurave nga taksat vendore**, duke shprehur ndikimin e sektorit të bujqësisë.

Taksa mbi Truallin kontribuon me **2.2% të totalit të të ardhurave** dhe **4.3% të të ardhurave nga taksat vendore**.

Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Legalizimet, zë një pjesë më të vogël në strukturën e të ardhurave, por gjithsesi të qëndrueshme, me **1.7% të totalit të të ardhurave** dhe **3.3% të të ardhurave nga taksat vendore**, duke reflektuar proceset në vijim të formalizimit të pronave.



1.TAKSA MBI NDËRTESEN

Taksa mbi ndërtesën mbetet një nga burimet kryesore të të ardhurave vendore për Bashkinë Korçë dhe luan rol thelbësor në financimin e shërbimeve dhe investimeve publike. Për vitin 2026, kjo taksë është planifikuar në vlerën **197,708,144 lekë**, duke përbërë **16.4% të planifikimit total vjetor të të ardhurave** për vitin 2026 dhe **33% të të ardhurave nga taksat vendore**.

Ky parashikim është hartuar në bazë të rritjes së bazës të taksueshme, rritjes së numrit të subjekteve në skemën e detyrimit, përmirësimit të administrimit fiskal dhe aplikimit të metodologjisë të vlerësimit të pronës. Ky nivel i parashikuar synon të reflektojë gjendjen reale të tregut të ndërtimit, situatën e ngarkesës fiskale të familjarëve dhe bizneseve, si dhe politikat aktuale të stimulimit dhe lehtësimit.

Parashikimi i të ardhurave është ndërtuar mbi tri shtylla kryesore:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Zgjerimi i bazës tatimore

Identifikimi i njësive të paregjistruara në skemën e taksimit.

Integrimi i të dhënave të reja nga terreni duke përfshirë dhe objektet që janë në proces legalizimi.

Evidentimi i objekteve në të cilat nuk ushtrohet aktivitet, të destinuara për veprimtari social-ekonomike.

Saktësimi i sipërfaqeve dhe vlerësimit të pronës

Verifikime fizike në terren për të përditësuar sipërfaqet në përdorim.

Vlerësim më i saktë i funksionit të pronës (banim, tregti, shërbime, prodhim, magazinim, e.t.j).

Harmonizim i të dhënave me regjistrat e A.SH.K. dhe sistemet fiskale.

Përmirësimi i administrimit të taksës

Trajnimi dhe mbështetja institucionale e agjentëve tatimorë.

Rritja e transparencës dhe komunikimit me taksapaguesit.

Thjeshtimi i procedurave për deklarim dhe pagesë.

Rezultatet e këtyre ndërhyrjeve reflektohen në numrin e lartë të njësive të përfshira në detyrim për vitin 2026: **34,851 njësi pronësore**, me një sipërfaqe totale **4,393,151.09 m²**, të cilat gjenerojnë **140,178,622 lekë** nga kjo taksë.

Parashikimi sipas kategorive të taksapaguesve:

Familjarët

Familjarët mbeten grupi kryesor në portofolin e kësaj takse, duke kontribuar me **71,378,289 lekë** për vitin 2026, bazuar në **29,711 njësi pronësore** me sipërfaqe totale **3,542,775 m²**.

- **Njësia Administrative Korçë**

- 20,437 njësi pronësore
- 2,279,583 m²
- **52,430,409 lekë të ardhura të parashikuara**

- **Njësitë e tjera administrative**

- 9,274 njësi pronësore
- 1,263,192 m²
- **18,947,880 lekë të ardhura të parashikuara**

Ky nivel përfaqëson stabilitet të bazës tatimore në zonat rurale dhe përfshin një potencial të mëtejshëm rritjeje, veçanërisht në zonat pranë qendrave turistike apo të zhvillimit.

Subjektet e biznesit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Të ardhurat nga kjo kategori janë planifikuar në **68,800,333 lekë**, mbi bazën e **5,140 njësive pronësore** dhe sipërfaqes **850,376.09 m²**. Ndërtesat e bizneseve paraqesin norma taksimi më të larta, duke reflektuar potencial të rëndësishëm të ardhurash në raport me sipërfaqen e përdorur.

➤ Njësia Administrative Korçë

- 2,642 njësi pronësore me sipërfaqe 273,093.36 m² të destinuara për tregëti dhe shërbime në vlerën **37,523,023 lekë**.
- 58 njësi pronësore me sipërfaqe 64,154.90 m² të destinuara për prodhim në vlerën **2,968,294 lekë**.
- 1,701 njësi pronësore me sipërfaqe 296,610.3 m² të destinuara për magazina si dhe objekte në të cilat nuk ushtrohet aktivitet në vlerën **13,584,752 lekë**.
- 252 njësi pronësore me sipërfaqe 26,959.95 m² të destinuara për bodrume, garazhd dhe parking të mbuluar në pronësi të subjekteve të biznesit apo në pronësi të individëve me vlerë **1,899,319 lekë**.

Në kategorinë e objekteve joaktive vërehet trend rritës i deklarimeve, i cili ndihmon në rritjen e transparencës dhe në vendosjen e detyrimeve të munguara në vite.

➤ Njësitë e tjera administrative

- 387 njësi pronësore me sipërfaqe 108,010.15 m² të destinuara për tregëti dhe shërbime në vlerën **9,666,908 lekë**.
- 72 njësi pronësore me sipërfaqe 61,947.43 m² të destinuara për prodhim në vlerën **2,837,191 lekë**.
- 28 njësi pronësore me sipërfaqe 19,600 m² të destinuara për blegtori në vlerën **350,840 lekë**.

Debitorët

Nga përmirësimi i ndjekjes së detyrimeve të prapambetura planifikohet të arkëtohen **57,529,522 lekë**, të ndarë si vijon:

- Familjarë – Njësia Korçë: **8,993,158 lekë**
- Familjarë – Njësitë e tjera: **14,122,111 lekë**
- Subjektet e biznesit dhe objekte në të cilat nuk ushtrohet aktivitet: **34,414,253 lekë**

Efekti ekonomik i përjashtimeve për taksën mbi ndërtesën.

Për vitin 2026, Bashkia Korçë do të aplikojë një politikë përjashtimore për grupet më të ndjeshme. Në total do të përjashtohen 4,408 familje, me sipërfaqe totale 461,473.4 m², të cilat përfaqësojnë një efekt financiar prej 9,623,183 lekë mungesë të ardhurash të mbuluara nga buxheti i bashkisë, masa këto që synojnë të ulin barrën fiskale për kategoritë në nevojë dhe të garantojnë një qasje të drejtë, të balancuar dhe të mbështetur në kritere transparente.

Taksa mbi ndërtesën mbetet një instrument i rëndësishëm fiskal që garanton të ardhura të qëndrueshme dhe të parashikueshme për zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe rural të Bashkisë Korçë.

2. TAKSA MBI TRUALLIN



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Taksa mbi truallin përbën një nga komponentët kryesorë të të ardhurave vendore në Bashkinë Korçë dhe për vitin 2026 ajo planifikohet të arrijë në **26,042,660 lekë**, duke reflektuar një kontribut të qëndrueshëm në buxhetin vendor. Ky nivel përfaqëson **2.2%** të totalit të planifikimit të të ardhurave për vitin 2026 dhe **4.3%** të të ardhurave nga taksat vendore.

Planifikimi mbështetet në disa elementë kryesorë teknikë:

- **Saktësimi i sipërfaqeve të truallit**

Përdorimi i verifikimeve në terren dhe përditësimi dokumentave të pronësisë ka sjellë minimizimin e gabimeve në deklarim, rritjen e bazës së taksueshme dhe identifikimin e njësive të reja.

- **Kategorizimi sipas qëllimit të përdorimit**

Ndarja e qartë midis truallit për qëllime biznesi dhe truall për qëllime banimi redukton trajtimet e padrejta fiskale.

- **Zgjerimi i numrit të taksapaguesve**

Pritet rritje përmes:

verifikimeve të gjendjes faktike në terren dhe bashëpunim me A.SH.K

identifikimit të njësive të reja dhe të paregjistruara,

përmirësimit të shërbimeve dhe edukimit të tatimpaguesit.

Të ardhurat e planifikuara prej **26,042,660 lekë** bazohen në:

Njësi pronësore truall për qëllime biznesi

Njësi pronësore: **863**

Sipërfaqe totale: **1,096,632.22 m²**

Të ardhurat e planifikuara: **15,062,866 lekë**

Përfaqëson 57.8% të të ardhurave totale të këtij zëri

Njësi pronësore truall për qëllime banimi

Njësi pronësore: **11,518**

Sipërfaqe totale: **3,519,095 m²**

Të ardhurat: **1,158,833 lekë**

Përfaqëson 4.4% të totalit të planifikuar

Megjithëse familjarët zotërojnë një sipërfaqe shumë më të madhe se bizneset, kontributi i tyre financiar është dukshëm më i ulët. Kjo vjen si pasojë e nivelit të ulët fiskal për truall për qëllime banimi.

Debitorët e njësive pronësore truall për qëllime biznesi

Të ardhurat e pritshme nga arkëtimi: **7,460,870 lekë**

Përfaqësojnë 28.6% të totalit

Ky nivel debitorësh është i konsiderueshëm dhe përbën gati një të tretën e planifikimit total. Kjo tregon: akumulim të detyrimeve nga vitet e mëparshme

nevojën për forcim të procedurave administrative dhe të komunikimit me bizneset potencial të madh rritjeje për buxhetin përmes fushatave të synuara të arkëtimit.

Debitorët e njësive pronësore truall për qëllime banimi

Të ardhurat e pritshme: **2,040,904 lekë**

Përfaqësojnë 7.8% të totalit

Debitorët familjarë reflektojnë një problematikë të moderuar e lidhur me:

-mosinformim i plotë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

-vështirësi financiare

-mospërditësimin e të dhënave të pronësisë

3.TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **53,311,030 lekë** dhe përbën **4.4%** të planifikimit total vjetor dhe **8.9%** të të ardhurave të taksave vendore. Parashikimi është hartuar mbi bazën e të dhënave të siguruar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve, informacioneve të disponuara dhe informacioneve të shkëmbyera me A.SH.K, të cilat evidentojnë një sipërfaqe totale prej **12,684.21 ha**.

Parashikimi për vitin 2026 mbështetet në:

- **Saktësimin e sipërfaqeve** së tokës bujqësore përmes verifikimit administrativ dhe në terren;
- **Zgjerimin e bazës së taksapaguesve**, duke identifikuar pronarë/posedues të tokës ende të paregjistruar në sistemin e taksave;
- **Rivlerësimin e gjendjes faktike** dhe përmirësimin e marrëdhënieve me taksapaguesit;
- **Bashkëpunimin e rritur me A.SH.K**, për përditësimin e të dhënave të pronësisë.

Konkretisht të detajuara paraqiten në tabelat e mëposhtme:



Nr.	Njësia administrative 2026	Sip / hektar	Vlera / lekë
1	Njësia administrative Korçë	393.1	803,325
2	Njësia administrative Bulgarec	3,722.88	7,182,496
3	Njësia administrative Drenovë	2,323.00	4,964,656
4	Njësia administrative Voskop	2,309.73	4,655,524
5	Njësia administrative Mollaj	1,793.45	4,124,927
6	Njësia administrative Vithkuq	1,269.28	1,995,394
7	Njësia administrative Voskopoje	611.52	856,129
8	Njësia administrative Lekas	261.22	365,714
	Totali	12,684.21	24,948,164

Kategoria e tokës (Boniteti)	Sipërfaqja/ha	Çmimi në lekë/hektar/vit	Vlera/lekë
Kategoria III	12.68	2,800	35,518
Kategoria IV	5,186.25	2,300	11,928,366
Kategoria V	4,249.54	1,900	8,074,131
Kategoria VI	1,900.61	1,600	3,040,968
Kategoria VII-X	1,335.13	1,400	1,869,180
TOTALI	12,684.21		24,948,164



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË



Konkretisht për vitin 2026 planifikohen të arkëtohen:

- Nga **12,684.21 ha** vlera e të cilëve përlogaritët në masën **24,948,164 lekë**, detyrim ky i vitit 2026
- Nga debitorët, vlera e të cilëve përlogaritët në masën **28,362,866 lekë**, debi kjo e përlogaritur për pronarët apo poseduesit e tokës bujqësore të cilët nuk e kanë paguar këtë taksë për vitin 2025 dhe për periudhën paraardhëse.

4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2026 planifikohet në vlerën **280,000,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.

Kjo taksë përbën:

- 23.2%** të totalit të të ardhurave;
- 46.7%** të të ardhurave nga taksat vendore.

Në buxhetin e vitit të kaluar, Bashkia kishte planifikuar të ardhura në shumën 280 milion lekë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja. Ky parashikim nuk u realizua, pasi ka pasur një ulje të konsiderueshme të volumit të lejeve të ndërtimit të lëshuara nga Bashkia Korçë.

Sipas kuadrit ligjor aktual, i cili ka pësuar ndryshime vitin e kaluar, lejet e ndërtimit për objektet mbi 6 kate, komplekset e banimit, resortet dhe zhvillimet e mëdha nuk jepen në nivel bashkie, por janë kompetencë e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT).

Gjatë vitit të kaluar, AZHT nuk ka miratuar asnjë leje të kësaj kategorie brenda territorit tonë, çka rezultoi në mosrealizimin e të ardhurave të planifikuara, pavarësisht parashikimit të bërë në buxhet. Për vitin aktual, Bashkia ka parashikuar sërish të ardhura në vlerën 280 milion lekë, bazuar në projeksione dhe në informacionet zyrtare të marra nga AZHT. Konkretisht:

- AZHT ka proceduar disa aplikime për të cilat Bashkia jonë ka dhënë mendim pozitiv në përputhje me detyrimet ligjore.
- Këto aplikime përfshijnë zhvillime që, në rast miratimi do të gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.
- Sipas komunikimeve institucionale, pritët që një pjesë e këtyre lejeve të miratohen brenda vitit, duke krijuar premisa reale për realizimin e të ardhurave të planifikuara prej 280 milion lekësh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

5. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2026 është planifikuar në **20,085,288 lekë**, bazuar në:

- numrin e legalizimeve të përfunduara në vitet 2024–2025,
- informacionet e shkëmbyera me A.SH.K.,
- debitorët ekzistues, të cilët janë objekt i masave shtrënguese gjatë vitit fiskal 2026.

Kjo taksë përbën:

- **1.7%** të totalit të të ardhurave;
- **3.3%** të të ardhurave nga taksat vendore.

6. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Taksa e fjetjes në hotel është një zë i rëndësishëm në strukturën e planifikimit të të ardhurave pasi lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e turizmit dhe rritjen e kapaciteteve pritëse në Bashkinë Korçë.

Kjo taksë për vitin 2026 planifikohet në vlerën **10,792,470 lekë**, mbështetur në të dhënat e përditësuara të kapaciteteve. Planifikimi është hartuar bazuar në inventarët e strukturave akomoduese të kategorizuara si më poshtë:

- 74 bujtina me kapacitet akomodues 1,035 persona që përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të turizmit tradicional dhe familjar
- 83 hotele me kapacitet akomodues 2,652 persona që ofrojnë shërbime të standartizuara dhe mbulojnë kërkesën në rritje për turizëm kulturor, biznesi apo eventesh.

Këto të dhëna dëshmojnë një rritje të qëndrueshme të numërit të vizitorëve dhe aktivitetit turistik, çka reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në akkëtimet në rritje nga kjo taksë.

Arkëtim gjatë vitit 2026 do të ketë dhe nga:

- Pagesat e muajit Dhjetor 2025, të cilat në përputhje me afat ligjore, kryhen brenda datës 5 Janar 2026 dhe reflektohen në realizimin e vitit 2026
- Detyrimet e prapambetura të këtyre subjekteve për vitin 2025 apo dhe periudhat paraardhëse të cilat janë objekt i masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi

Taksa e fjetjes në hotel në vetvete përfaqëson një instrument të rëndësishëm fiskal jo vetëm në gjenerimin e të ardhurave, por dhe në monitorimin e aktivitetit turistik dhe hartimit të politikave për zhvillimin e sektorit.

7. TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes:

I. Tabela për qëllime identifikimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- Këto tabela janë mbi 2 m², të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillohet aktiviteti i biznesit.
- Ato nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.
- Në këto tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.
- Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.

II. Tabela për qëllime reklamimi

- Përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës.
- Mund të jenë të thjeshta ose elektronike.
- Përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.

III. Tabela për qëllime ekspozimi

- Përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, si për ekspozime të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2026

- Vlera e planifikuar e taksës së tabelës është **11,936,388 lekë**.
- Ky parashikim është përgatitur nga **Drejtoria e Kontrollit të Territorit**, duke u bazuar në:
 - Administrimin dhe pasurimin e të dhënave për numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim;
 - Numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese mbi 2 m² dhe sipërfaqen e tyre;
 - Numrin e subjekteve që kanë vendosur tabela reklamuese dhe sipërfaqen e tyre;
 - Debitorët aktualë në Bashkinë Korçë.

Konkretisht të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Taksa e Tabelës	Nr. subjekte	Sipërfaqja m ²	Vlefte/njësi	TOTAL
1	Tabelë e thjeshtë	39	217.6	22,500	4,895,325
2	Tabelë e thjeshtë (mbi 2 m ² deri 10m ²)	10	46.7	10,000	467,400
3	Tabelë me ndriçim (mbi 2 m ² deri 10m ²)	38	183.3	15,000	2,750,160
4	Tabele Elektronike (mbi 2 m ² deri 10m ²)	1	4.2	20,000	83,200
5	Tabelë e thjeshtë (mbi 10 m ² deri 40m ²)	2	58.4	8,250	481,718
6	Tabele Elektronike (deri në tavanin 35m ²)	3	65.21	45,000	2,934,450
7	Tabelë e thjeshtë (mbi 10 m ² deri 20m ²)	1	13.54	12,750	172,635
	Debitorë	1	2.1	15,000	31,350
		3	5.3	22,500	120,150
		98	591		11,936,388



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË**TARIFAT VENDORE****Tarifat vendore zenë 39.3 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen gjatë vitit 2026**

B	TË ARDHURA JO TATIMORE	Realizim 2023	Realizim 2024	Plani 2025	Realiz.11 muaj 2025	I pritshëm 2025	Plani 2026
1	TARIFË PASTRIMI	155,899,754	166,159,371	194,856,576	161,058,960	171,763,984	198,607,826
2	TARIFË NDRIÇIMI	35,904,083	47,785,556	59,919,515	48,567,649	51,553,062	62,570,169
3	TARIFË GJELBËRIMI	22,503,572	30,878,675	38,277,978	31,641,133	33,542,774	39,736,214
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE	12,436,440	13,834,616	16,792,970	12,655,874	13,806,827	17,199,638
5	TARIFË ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE	21,073,198	21,722,880	28,861,347	17,966,331	19,510,291	24,528,140
6	TARIFË SERVITUTI	697,334	806,101	547,848	851,195	851,195	1,087,107
7	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	1,094,405	1,476,350	1,555,000	1,268,520	1,338,520	1,610,000
8	TARIFË MUR PERIMETRAL	930,840	758,895	2,000,000	704,604	872,604	3,000,000
9	TARIFË PARKIMI	18,738,137	19,522,111	23,969,902	17,409,020	18,709,020	23,539,060
10	TE ARDHURA TE TJERA	14,590,532	11,578,489	23,562,425	24,258,149	25,639,235	6,199,384
11	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	468,000	530,250	510,000	502,000	515,000	1,130,000
12	MIRATIM PROJEKTI	1,167,000	965,000	1,000,000	1,080,000	1,110,000	1,000,000
13	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA	-	-	30,000	-	-	10,000
14	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETEVE	-	-	40,000	-	-	340,000
15	MARRJE ME QERA PYLLI+ QERA PER KULLOTA	7,323,335	5,660,751	8,312,400	6,096,788	6,176,788	9,500,000
16	GJOBA MZSH	-	-	-	-	-	100,000
17	TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT	-	-	100,000	-	-	100,000
18	VËRTETIME TRANSPORTI	29,400	30,000	30,000	21,200	23,000	30,000
19	PRODHIMET E DYTA MIDICINALE	-	-	1,000,000	-	-	1,000,000
20	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	181,000	346,000	2,000,000	570,400	613,400	1,678,000
21	GJOBA PËR VONESË NË PAGESË	5,789,162	7,116,472	8,540,500	8,065,594	8,765,594	12,488,506
22	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	2,813,804	1,572,862	2,500,000	1,736,343	1,744,495	4,136,010
23	GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	70,000	40,000	100,000	40,000	80,000	100,000
24	GJOBA TË D.T.T.V	120,000	180,000	220,000	140,000	180,000	200,000
25	QIRA OBJEKTI,QERA TRUALLI,QERA T.BUJQËSORE	10,426,524	9,612,474	11,756,222	8,473,101	9,485,226	17,894,150
26	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	640,000	450,000	1,000,000	500,000	510,000	1,200,000
27	TARIFE PËR LEJE NDËRTIMI	325,200	258,000	700,000	212,500	227,500	750,000
28	TË ARDHURA NGA QIRATË, BANESA SOCIALE (CEB)	6,879,735	8,133,349	8,513,088	7,560,574	8,601,845	8,596,908
29	TË ARDHURA NGA BANESA SHTETËRORE	92,886	102,333	72,000	69,259	45,900	54,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

30	QIRA NGA BANESAT NË PRONËSI TË BASHKISË E.K.B + PRIVATIZIMI I BANESAVE	168,464	96,000	524,000	88,000	96,000	188,000
31	PRIVATIZIM BANESE	8,099,635	2,679,024	2,613,180	2,457,770	2,652,671	2,038,158
32	KAMATË VONESA(QIRA OBJEKT)	295,019	232,542	180,000	308,827	355,457	300,000
33	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	3,018,608	1,092,786	3,500,000	1,501,476	2,001,476	5,100,000
34	TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SISTEMIT KULLUES	9,248,941	10,819,688	29,266,429	10,584,629	11,534,503	27,997,375
	TOTALI B	341,025,006	364,440,574	472,851,380	366,389,896	392,306,367	474,008,645

Struktura e të ardhurave nga tarifat vendore tregon qartë kontributin specifik që secila tarifë jep në buxhetin e përgjithshëm të bashkisë. Nga analiza rezulton se disa tarifa mbeten burime kryesore financimi për ofrimin e shërbimeve publike, ndërsa të tjerat kanë peshë më të moderuar.

Tarifa e pastrimit përbën **16.4%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe siguron **42%** të të ardhurave nga tarifat vendore. Kjo tregon se tarifa e pastrimit mbetet një nga kontributorët kryesorë në financimin e shërbimit të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Tarifa e ndriçimit zë **5.2%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore dhe përfaqëson **13.2%** të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore. Kontributi i saj lidhet drejtpërdrejt me sigurimin e shërbimit të ndriçimit publik dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ndriçuese.

Tarifa e gjelbërimit përbën **3.3%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore dhe gjeneron **8.4%** të të ardhurave nga tarifat vendore. Kjo tregon rolin e saj në financimin e shtimit dhe mirëmbajtjes periodike të hapësirave të gjelbra, parqeve dhe mirëmbajtjes dekorative urbane.

Tarifa për zënien e hapësirave publike përbën **2%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore, duke gjeneruar **5.2%** të të ardhurave nga tarifat vendore. Kjo tarifë ka rol të rëndësishëm në administrimin e përdorimit të ambienteve publike për qëllime biznesi apo aktivitete të përkohshme.

Tarifa e parkimit përbën **1.9%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore, duke gjeneruar **5%** të të ardhurave nga tarifat vendore.

Tarifa vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues zë **2.3%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore dhe siguron **5.9%** të të ardhurave të tarifave vendore. Tarifa mbështet funksionimin e infrastrukturës kulluese dhe rrugëve të parcelave.

1.TARIFA E PASTRIMIT

Tarifa e pastrimit përbën një nga zërat kryesorë të të ardhurave vendore të Bashkisë Korçë dhe mbetet element i rëndësishëm për garantimin e standardeve dhe menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë. Për vitin 2026, ky zë është planifikuar në shumën **198,607,826 lekë**, duke përfaqësuar **16.4%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore dhe **42%** të totalit të të ardhurave nga tarifat vendore. Këto tregues



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

nënvizojnë peshën specifike që kjo tarifë ka në strukturën e të ardhurave dhe rëndësinë e saj në financimin e shërbimeve publike.

Parashikimi për vitin 2026 është hartuar në përputhje me objektivin e bashkisë për të forcuar administrimin fiskal dhe për të përmirësuar ndjeshëm evidentimin e subjekteve dhe familjeve që përfshihen në këtë tarifë. Zgjerimi i bazës është mbështetur në:

- **Përditësimin sistematik të të dhënave** në sistemin elektronik të taksave dhe tarifave vendore, duke eliminuar pasaktësitë e krijuara ndër vite.
- **Verifikimin në terren** nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative, i cili ka mundësuar identifikimin e familjeve efektive rezidente.
- **Kontrollet e inspektorëve të D.T.T.V**, me fokus evidentimin e aktiviteteve tregtare dhe shërbimeve që ushtrohen realisht.
- **Bashkëpunimin institucional** me QKB, DRT, SH.R.U.K.KO dhe Zyrën e Gjendjes Civile, për të siguruar përditësim të vazhdueshëm të numrit të subjekteve ekonomike dhe familjeve të regjistruara.

Këto ndërhyrje synojnë jo vetëm rritjen e të ardhurave, por edhe krijimin e një baze tarifimi më të drejtë, transparente dhe të barabartë për të gjithë kontribuesit në territorin e bashkisë.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

- ✓ 2,617 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **29,095,100 lekë**
- ✓ 739 subjekte të biznesit të madh në vlerën **42,699,000 lekë**
- ✓ 79 institucione shtetërore dhe ojf në vlerën **2,116,000 lekë**
- ✓ subjektete ndërtuese për kantieret e ndërtimit në vlerën **4,000,000 lekë**
- ✓ 19,948 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **75,802,400 lekë**
- ✓ 7,866 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën **11,615,000 lekë**
- ✓ debitorët familjarë në vlerën **15,149,572 lekë**
- ✓ debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën **18,130,754 lekë**

Rritja e të ardhurave nga familjet dhe subjektet e biznesit është reflektim i drejtpërdrejtë i përmirësimit të evidentimeve, verifikimeve në terren dhe masave të ndërmarra për reduktimin e informalitetit.

Efekti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e pastrimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Bashkia Korçë ka vijuar zbatimin e lehtësive fiskale dhe përjashtimeve nga tarifa e pastrimit. Efekti financiar i këtyre politikave për vitin 2026 vlerësohet në total 15,816,600 lekë, nga 63 subjekte dhe 3,889 familje që përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit si rezultat i lehtësive fiskale.

2.TARIFË NDRIÇIMI

Tarifa e ndriçimit përbën një ndër zërat kryesorë të të ardhurave vendore të Bashkisë Korçë. Për vitin 2026, ky zë është planifikuar në shumën **62,570,169 lekë**, duke përfaqësuar **5.2%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore dhe **13.2%** të totalit të të ardhurave nga tarifat vendore. Këto tregues tregojnë peshën specifike që kjo tarifë ka në strukturën e të ardhurave dhe rëndësinë e saj në financimin e shërbimeve publike.

Parashikimi për vitin 2026 është hartuar në përputhje me objektivin e bashkisë për të forcuar administrimin fiskal dhe për të përmirësuar ndjeshëm evidentimin e subjekteve dhe familjeve që përfshihen në këtë tarifë. Zgjerimi i bazës është mbështetur në:

- **Përditësimin sistematik të të dhënave** në sistemin elektronik të taksave dhe tarifave vendore, duke eliminuar pasaktësitë e krijuara ndër vite.
- **Verifikimin në terren** nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative, i cili ka mundësuar identifikimin e familjeve efektive rezidente.
- **Kontrollet e inspektorëve të D.T.T.V**, me fokus evidentimin e aktiviteteve tregtare dhe shërbimeve që ushtrohen realisht.
- **Bashkëpunimin institucional** me QKB, DRT, SH.R.U.K.KO dhe Zyrën e Gjendjes Civile, për të siguruar përditësim të vazhdueshëm të numrit të subjekteve ekonomike dhe familjeve të regjistruara.

Këto ndërhyrje synojnë jo vetëm rritjen e të ardhurave, por edhe krijimin e një bazë tarifimi më të drejtë, transparente dhe të barabartë për të gjithë kontribuesit në territorin e bashkisë.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

- ✓ 2,617 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **16,558,650 lekë**
- ✓ 739 subjekte të biznesit të madh në vlerën **8,708,000 lekë**
- ✓ 79 institucione shtetërore dhe ojf në vlerën **571,500 lekë**
- ✓ subjektete ndërtuese për kantieret e ndërtimit në vlerën **300,000 lekë**
- ✓ 19,948 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **19,498,600 lekë**
- ✓ 7,866 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën **5,261,600 lekë**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- ✓ debitorët familjarë në vlerën **5,290,635 lekë**
- ✓ debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën **6,381,184 lekë**

Rritja e të ardhurave nga familjet dhe subjektet e biznesit është reflektim i drejtpërdrejtë i përmirësimit të evidentimeve, verifikimeve në terren dhe masave të ndërmarra për reduktimin e informalitetit.

Efekti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e ndriçimit.

Bashkia Korçë ka vijuar zbatimin e lehtësive fiskale dhe përjashtimeve nga tarifa e ndriçimit. Efekti financiar i këtyre politikave për vitin 2026 vlerësohet në total 3,864,350 lekë, nga 63 subjekte dhe 5,998 familje që përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së ndriçimit si rezultat i lehtësive fiskale.

3.TARIFË GJELBËRIMI

Tarifa e gjelbërimit përbën një ndër zërat kryesorë të të ardhurave vendore të Bashkisë Korçë. Për vitin 2026, ky zë është planifikuar në shumën **39,736,214 lekë**, duke përfaqësuar **3.3%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore dhe **8.4%** të totalit të të ardhurave nga tarifatat vendore. Këto tregues, tregojnë peshën specifike që kjo tarifë ka në strukturën e të ardhurave dhe rëndësinë e saj në financimin e shërbimeve publike.

Parashikimi për vitin 2026 është hartuar në përputhje me objektivin e bashkisë për të forcuar administrimin fiskal dhe për të përmirësuar ndjeshëm evidentimin e subjekteve dhe familjeve që përfshihen në këtë tarifë. Zgjerimi i bazës është mbështetur në:

- **Përditësimin sistematik të të dhënave** në sistemin elektronik të taksave dhe tarifave vendore, duke eliminuar pasaktësitë e krijuara ndër vite.
- **Verifikimin në terren** nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative, i cili ka mundësuar identifikimin e familjeve efektive rezidente.
- **Kontrollet e inspektorëve të D.T.T.V**, me fokus evidentimin e aktiviteteve tregtare dhe shërbimeve që ushtrohen realisht.
- **Bashkëpunimin institucional** me QKB, DRT, SH.R.U.K.KO dhe Zyrën e Gjendjes Civile, për të siguruar përditësim të vazhdueshëm të numrit të subjekteve ekonomike dhe familjeve të regjistruara.

Këto ndërhyrje synojnë jo vetëm rritjen e të ardhurave, por edhe krijimin e një bazë tarifimi më të drejtë, transparente dhe të barabartë për të gjithë kontribuesit në territorin e bashkisë.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga :

- ✓ 2,329 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **13,217,250 lekë**
- ✓ 739 subjekte të biznesit të madh në vlerën **5,604,000 lekë**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- ✓ 79 institucione shtetërore dhe ojf në vlerën **497,300 lekë**
- ✓ subjektete ndërtuese për kantieret e ndërtimit në vlerën **450,000 lekë**
- ✓ 19,948 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **13,664,000 lekë**
- ✓ debitorët familjarë të njësisë administrative Korçë në vlerën **1,588,477 lekë**
- ✓ debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën **4,715,187 lekë**

Efekti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e gjelbërimit.

Bashkia Korçë ka vijuar zbatimin e lehtësive fiskale dhe përjashtimeve nga tarifa e gjelbërimit. Efekti financiar i këtyre politikave për vitin 2026 vlerësohet në total 2,226,350 lekë, nga 63 subjekte dhe 4,279 familje që përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së gjelbërimit si rezultat i lehtësive fiskale.

4.TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

Tarifa e mirëmbajtjes së varezave publike për vitin 2026 është planifikuar në shumën **17,199,638 lekë**, duke përfaqësuar **1.4%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore dhe **3.6%** të totalit të të ardhurave nga tarifat vendore.

Parashikimi për vitin 2026 është hartuar në përputhje me objektivin e bashkisë për të forcuar administrimin fiskal dhe për të përmirësuar ndjeshëm evidentimin e familjeve që përfshihen në këtë tarifë. Zgjerimi i bazës është mbështetur në:

- **Përditësimin sistematik të të dhënave** në sistemin elektronik të taksave dhe tarifave vendore, duke eliminuar pasaktësitë e krijuara ndër vite.
- **Verifikimin në terren** nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative, i cili ka mundësuar identifikimin e familjeve efektive rezidente.
- **Bashkëpunimin institucional** me SH.R.U.K.KO dhe Zyrën e Gjendjes Civile, për të siguruar përditësim të vazhdueshëm të numrit të familjeve të regjistruara.

Këto ndërhyrje synojnë jo vetëm rritjen e të ardhurave, por edhe krijimin e një bazë tarifimi më të drejtë, transparente dhe të barabartë për të gjithë kontribuesit në territorin e bashkisë.

. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga:

- ✓ 19,948 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **9,974,000 lekë**
- ✓ 7,866 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën **3,933,000 lekë**
- ✓ debitorët familjarë parashikohet në vlerën **3,292,638 lekë**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË**Efekti ekonomik i përjashtimeve për tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike.**

Bashkia Korçë ka vijuar zbatimin e lehtësive fiskale dhe përjashtimeve nga tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike. Efekti financiar i këtyre politikave për vitin 2026 vlerësohet në total 1,944,500 lekë, nga 3,889 familje që përjashtohen nga pagesa e tarifës së mirëmbajtjes së varrezave publike si rezultat i lehtësive fiskale.

5.TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Tarifa për zënien e hapësirave publike për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **24,528,140 lekë**, e cila është përlogaritur mbi bazën e vlerësimeve të kryera nga **Drejtoria e Kontrollit të Territorit**. Parashikimi mbështetet në analizën e sipërfaqeve ekzistuese dhe atyre që pritet të përdoren gjatë vitit 2026 për qëllime të ndryshme të shfrytëzimit të hapësirës publike.

Këto qëllime përfshijnë, ndër të tjera:

- vendosjen e tavolinave të shërbimit jashtë ambienteve të lokaleve;
- instalimin e platformave, rrethimeve me kangjella apo elementë dekorativë si vazo lulesh;
- përdorimin e hapësirave publike për tregtim në tregjet e miratuara nga bashkia, për produkte ushqimore, fruta-perime, mish, peshk, bulmet, vezë etj.;
- aktivitetin tregtar të artikujve industrialë në hapësirat e inkubatorit të biznesit (ish-UMB);
- organizimin e eventeve të ndryshme, panaireve apo aktiviteteve të përkohshme;
- vendosjen e strukturave të tipit kantina, kënde lojërash apo njësi të tjera shërbimi;
- përdorimin e hapësirave për tregtimin në tregun e gjësë së gjallë.

Në raport me vëllimin total të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, kjo tarifë zë **2% të totalit të planifikuar për vitin 2026** dhe **5.2% të totalit të të ardhurave të pritshme nga tarifat vendore**. Planifikimi i bërë synon të reflektojë dinamikën e përdorimit të hapësirave publike, si dhe rritjen e kërkesës për to në funksion të zhvillimit ekonomik dhe aktivitetit tregtar në territorin e bashkisë.

Në lekë

Nr.	Tarifë zënie hapësirë publike	Vlera vjetore
1	Me tavolina jashtë lokalit	10,241,116
2	Ekspozim malli	1,100,030
3	Atkivitet fast-food (Kantina)	396,000
4	Promocione	30,000
5	Tregu industrial (ish UMB)	3,292,000
6	Tregu ushqimor Markata e Shijes	3,336,000
7	Tregu i gjësë së gjallë	1,200,000
8	Hapësirë publike me objekte provizore	357,335
9	Debitorë	4,575,659



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA KORÇË**Total****24,528,140****Efekti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën zënies së hapësirës publike.**

Për vitin 2026 vlera prej **1,730,070 lekë** përlogaritet si rezultat i përjashtimit nga tarifimi i subjekteve që shërbejnë me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike për muajt Janar-Shkurt dhe Dhjetor 2026.

6.TARIFA PËR SERVITUT KALIMI NË PRONA PUBLIKE

Tarifa për servitutit e kalimit në pronat publike për vitin 2026 është planifikuar në shumën **1,087,107 lekë**, e cila është përlogaritur mbi bazën e vlerësimeve të kryera nga **Drejtoria e Kontrollit të Territorit**. Parashikimi mbështetet në verifikimet, analizën e sipërfaqeve ekzistuese dhe atyre që pritet të përdoren gjatë vitit 2026.

- **Parashikimi për vitin 2026**, i bazuar në ecurinë e viteve të mëparshme, është vlerësuar në shumën **830,367 lekë**.
- **Detyrimet e prapambetura**, që përfshijnë gjoba të pambledhura nga vitet e kaluara, përbëjnë shumën **256,740 lekë**.

7.TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Për vitin 2026, tarifa e regjistrimit për lejë transporti është planifikuar në vlerën **1,610,000 lekë**, parashikim i hartuar nga **Drejtoria e Kontrollit të Territorit**. Ky planifikim bazohet në analizën e trendit të aplikimeve për rinovimin e licencave ekzistuese dhe lëshimin e licencave të reja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve dhe mallrave, si për nevojat e vetë subjekteve ashtu edhe për ofrim shërbimesh për të tretë.

Vlerësimi i të ardhurave është ndërtuar duke marrë në konsideratë dinamikën aktuale të tregut, ciklin e rinovimit të çertifikatave, autorizimeve, si dhe strukturën e flotës së mjeteve që operojnë në territorin e Bashkisë.

Parashikimi është i ndarë sipas kategorive kryesore, si më poshtë:

- **Transporti i udhëtarëve me taksì:** Planifikohet të realizojë të ardhura në vlerën **400,000 lekë**. Ky parashikim bazohet në ritmin e rinovimeve të licencave në këtë kategori dhe në kërkesën për këtë shërbim të transportit urban dhe ndërrurban.
- **Transporti i mallrave:** Planifikohet në total **990,000 lekë**. Pjesën kryesore të kësaj kategorie e përbëjnë mjetet e subjekteve të ndërtimit me tonazh të lartë. Duhet theksuar se, sipas kërkesave të subjekteve, shumica e këtyre mjeteve janë pajisur me certifikata dhe autorizime me afat mbi njëvjeçar, çka ndikon në ciklin e rinovimit dhe ritmin e mbledhjes së të ardhurave.
- **Transporti i udhëtarëve:** Planifikohet të kontribuojë me **220,000 lekë**, duke reflektuar mesataren historike të aplikimeve dhe rinovimeve të subjekteve që ushtrojnë këtë shërbim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË**8.TARIFË PËR MUR PERIMETRAL**

Tarifë për mur perimetral për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **3,000,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.

9.TARIFË PARKIMI

Për vitin buxhetor 2026, të ardhurat nga tarifa e parkimit janë planifikuar në vlerën totale **23,539,060 lekë**. Planifikimi është realizuar nga **Drejtoria e Kontrollit të Territorit**, e cila ka vlerësuar kapacitetet ekzistuese, kërkesën e pritshme dhe performancën e viteve të mëparshme.

Tarifa e parkimit për vitin 2026 përfaqëson **1.9%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore dhe **5%** të totalit të të ardhurave nga tarifat vendore.

Parashikimi është i detajuar sipas zërave përbërës si më poshtë:

1. Tarifa për vendet e rezervuara të parkimit

- 102 subjekte
- 153 vende parkimi të rezervuara me intervale të ndryshme kohore
- Të ardhurat e planifikuara: **7,000,000 lekë** (duke pasur parasysh dhe trendin e kërkesave për parkime të rezervuara ndër vite)

2. Tarifa për parkimet me pagesë

- 325 vende parkimi të dedikuara për përdorim me pagesë
- Të ardhurat e pritshme: **15,000,000 lekë**

3. Tarifa e parkimit rezident

- Të ardhurat e planifikuara: **51,600 lekë**

4. Tarifa për mjetet e transportit të mallrave

Përfshin mjetet që transportojnë mall për llogari të vet ose të tretëve

- Të ardhurat e parashikuara: **500,000 lekë**

5. Tarifa për licencat e mjeteve taksi (1+4 vende)

- 97 licenca aktive
- Të ardhurat e pritshme: **412,000 lekë**

6. Debitorët për tarifën e parkimit

- Të ardhura të pritshme për vitin 2026: **575,460 lekë**

10.TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera (tarifa shërbimi, vërtetime, certifikata,etj) për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **6,199,384 lekë**, parashikim ky i bazuar në të dhënat e mara nga drejtoritë apo institucionet përkatëse.

Të ardhura të tjera	Vlera/lekë
Kamatë vonesa	500,000
Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	1,744,384
Tarifa administrative dhe rregullatore të Nj. Vendore	60,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore	50,000
Tarifë vendore për lëshime vërtetimi	320,000
Tarifë vendore për konfirmim hartash	25,000
Tarifë vendore për certifikatë përdorimi	3,500,000
TOTALI	6,199,384

11.ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Të ardhurat nga lëshimi i certifikatave për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2026 referuar trendit të viteve të mëparshme, ecures gjatë vitit 2025 dhe pritshmërisë janë planifikuar në vlerën **1,130,000 lekë**. Parashikimi është përgatitur nga **Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit**, bazuar në kërkesat dhe ritmin e aplikimeve të viteve të mëparshme.

12.MIRATIM PROJEKTI

Të ardhurat nga miratimi i projekteve, si pjesë e detyrimeve të subjekteve ndaj shërbimeve zjarrfikse dhe të sigurisë, për vitin 2026 referuar trendit të viteve të mëparshme, ecures gjatë vitit 2025 dhe pritshmërisë janë planifikuar në shumën **1,000,000 lekë**. Parashikimi është propozuar nga **Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit**.

13.SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA

Të ardhurat që pritet të gjenerohen nga ofrimi i shërbimeve zjarrfikse në objekte të siguruar gjatë vitit 2026 janë parashikuar në vlerën **10,000 lekë**, sipas parashikimit të bërë nga **Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit**.

14.SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TË TRETËVE

Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve zjarrfikse për palë të treta, përfshirë ndërhyrje, asistencë teknike apo shërbime specifike sipas kërkesës, për vitin 2026 janë planifikuar 170 raste referuar trendit të viteve të mëparshme në vlerën **340,000 lekë**. Edhe ky zë është parashikuar nga **Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit**.

15. GJOBA MZSH

Të ardhurat nga gjobat për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **100,000 lekë** sipas parashikimit të bërë nga **Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit**.

16.MARRJE ME QIRA PYLLI / KULLOTA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Të ardhurat nga **marrja me qira e pyjeve dhe kullotave** për vitin 2026 janë planifikuar në shumën **9,500,000 lekë**. Ky parashikim është hartuar nga **Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores**, duke u mbështetur në analizën e kontratave ekzistuese, ritmit të pagesave dhe projeksioneve të qëndrueshme për shfrytëzimin e fondit pyjor dhe kullësor.

Vlera totale e planifikuar reflekton kontratat e lidhura me subjekte të ndryshme, të cilat shfrytëzojnë hapësira të fondit pyjor/kullësor për qëllime ekonomike, rekreative, infrastrukturore apo studimore. Struktura e kontratave është e detajuar si më poshtë:

- **Kontrata qiraje për pushim–argëtim**

Vlera vjetore: **175,725 lekë**

Kjo kategori përfshin hapësira të dhëna me qira për aktivitete turistike dhe rekreative në zonat pyjore.

- **5 kontrata qiraje me operatorët celularë**

Vlera totale: **1,027,606 lekë**

Përfshijnë shfrytëzimin e territorit pyjor për instalimin e antenave dhe infrastrukturës së komunikimit elektronik.

- **2 kontrata qiraje për mbjellje arrorësh**

Vlera totale: **694,200 lekë**

Kategoria lidhet me investime afatgjata në kultivimin e pemëve arrorë në sipërfaqe pyjore.

- **33 kontrata qiraje për kullotje**

Vlera totale: **4,053,039 lekë**

Këto kontrata përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave, pasi përfshijnë përdorimin sezonal të kullotave nga blegtorët dhe subjektet bujqësore.

- **8 kontrata qiraje për hidrocentrale (HEC)**

Vlera totale: **2,344,600 lekë**

Lidhur me shfrytëzimin e territorit pyjor/kullësor për infrastrukturë energjetike.

- **3 kontrata qiraje për shfrytëzim mineral–gëlqeror**

Vlera totale: **1,159,830 lekë**

Përfshijnë përdorimin e sipërfaqeve për nxjerrjen e materialeve gëlqerore, sipas lejeve përkatëse.

- **2 kontrata qiraje për qëllime studimi**

Vlera totale: **45,000 lekë**

Përfshijnë hapësirat e dhëna për studime shkencore apo survejime teknike.

Totali i të ardhurave të pritshme prej 9.5 milion lekë për vitin 2026 përfaqëson një bilanc të qëndrueshëm të shfrytëzimit të fondit pyjor dhe kullësor, duke kombinuar kontrata me karakter ekonomik, energjitik, bujqësor dhe rekreativ. Ky parashikim siguron një burim të rëndësishëm të ardhurash për buxhetin vendor, duke garantuar njëkohësisht menaxhim të qëndrueshëm të pasurisë natyrore.

17.TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT DHE HEQJA E MATERIALIT DRUSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe heqja e materialit drusor për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **100,000 lekë**, parashikim ky i bërë nga **Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores** pranë Bashkisë Korçë.

18.VËRTETIME TRANSPORTI

Të ardhurat nga lëshimi i vërtetimeve të transportit për vitin 2026 janë planifikuar në vlerën **30,000 lekë**. Ky parashikim, i përgatitur nga **Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores**, mbështetet në numrin mesatar të kërkesave të viteve të mëparshme dhe nevojave të pritshme të subjekteve.

19.PRODHIMET E DYTA MEDICINALE

Të ardhurat nga prodhimet e dyta medicinale për vitin 2026 janë planifikuar në vlerën **1,000,000 lekë**. Parashikimi është bërë nga **Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores**, duke marrë në konsideratë potencialin e territorit për grumbullimin e bimëve medicinale, kërkesën në rritje të tregut si dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit me subjektet e licencuara për mbledhjen dhe tregtimin e këtyre produkteve.

20.GJOBA POLICIA BASHKIAKE

Gjoba Policia Bashkiake për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **1,678,000 lekë** duke përfshirë dhe gjobat e pa mbledhura gjatë vitit ushtrimor korent apo atij të mëparshëm.

- **Parashikimi për vitin 2026**, i bazuar në ecurinë e viteve të mëparshme, është vlerësuar në shumën **1,500,000 lekë**.
- **Detyrimet e prapambetura**, që përfshijnë gjoba të pambledhura nga vitet e kaluara, përbëjnë shumën **178,000 lekë**.

21.GJOBË PËR VONESË NË PAGESË

Gjobat për vonesë në pagesë për vitin 2026 janë parashikuar në shumën **12,488,506 lekë**. Ky parashikim mbështetet në:

- **Detyrimet e papaguara të viteve të mëparshme**, të cilat vazhdojnë të gjenerojnë penalitete për mosshlyerje në afat;
- **Subjektet që nuk kanë kryer pagesat brenda vitit ushtrimor**, për të cilat vijon të llogaritet gjoba për vonesë;
- **Ecurinë e të ardhurave gjatë vitit aktual**, e cila ofron një tregues realist mbi pritshmëritë për vitin pasardhës.

Ky parashikim synon të reflektojë me saktësi nivelin e penaliteteve që pritet të arkëtohen, duke u bazuar në tendencat historike dhe situatën aktuale të pagesave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

22.GJOBA TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

Për vitin 2026, të ardhurat nga **Gjobat e Inspektoriatit Ndërtimor Vendor** janë planifikuar në shumën totale prej **4,136,010 lekësh**. Ky planifikim është ndërtuar mbi dy komponentë kryesorë:

- **Parashikimi për vitin 2026**, i bazuar në ecurinë e viteve të mëparshme, është vlerësuar në shumën **1,000,000 lekë**.
- **Detyrimet e prapambetura**, që përfshijnë gjoba të pambledhura nga vitet e kaluara, si dhe ato që aktualisht ndodhen në proces gjyqësor ose janë kaluar për ekzekutim në përmbarim, përbëjnë shumën **3,136,010 lekë**.

23. GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT

Të ardhurat nga gjobat e vendosura nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit për vitin 2026 janë planifikuar në shumën **100,000 lekë**. Parashikimi është hartuar duke u bazuar në aktivitetin inspektues të vitit aktual, si dhe në pritshmëritë për forcimin e monitorimit dhe zbatimit të rregullave në fushën e infrastrukturës, mjedisit, fushën e transportit e.t.j gjatë vitit të ardhshëm.

24.GJOBA TË D.T.T.V

Të ardhurat nga gjobat e vendosura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2026 janë planifikuar në vlerën **200,000 lekë**. Ky parashikim mbështetet në:

- ecurinë e mbledhjes gjatë vitit aktual,
- detyrimet e paguara deri në fund të vitit 2025,
- informacionin e gjeneruar nga sistemi i administrimit të taksave dhe tarifave vendore, i cili evidenton shkeljet dhe mospërputhjet në deklaram e pagesë nga subjekti tatimpagues.

25.QIRA OBJEKTI/TRUALLI/TOKË BUJQËSORE E.T.J

Për vitin fiskal 2026, të ardhurat nga qiraja e objekteve, truallit, tokës bujqësore, fondit pyjor dhe kategorive të tjera të pasurive të bashkisë janë planifikuar në shumën totale **17,894,150 lekë**. Ky zë përfaqëson **1.5%** të planifikimit total për vitin 2026 dhe **3.8%** të planifikimit nga të ardhurat jo tatimore.

Planifikim ky në bazë të:

- numrit dhe sipërfaqes së pasurive të dhëna me qira,
- kontratave aktive,
- detyrimeve të paguara nga subjekte debitorë,
- si dhe informacionit të administruar nga **Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Planifikimi sipas kategorive paraqitet si më poshtë:

- **Qira objekti: 4,691,520 lekë**, që përfaqëson të ardhurat nga përdorimi i ambienteve dhe objekteve në pronësi të bashkisë.
- **Qira trualli: 6,269,276 lekë**, e bazuar në sipërfaqet e truallit të dhëna në përdorim afatshkurtër dhe afatgjatë.
- **Qira tokë bujqësore: 99,661 lekë**, që lidhet me parcelat e tokës bujqësore të lëshuara me kontrata qiraje.
- **Të ardhura nga debitorët: 6,833,693 lekë**, të cilat përfshijnë detyrimet e prapambetura dhe borxhin e akumuluar nga kontratat ekzistuese të cilat janë në procese gjyqësore dhe arkëtimi i tyre mund të kryhet gjatë vitit 2026 në varësi të ecurisë së proceseve.

26.TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIM

Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **1,200,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.

27.TARIFË PËR LEJË NDËRTIMI

Tarifë për lejë ndërtimi për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **750,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.

28.TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)

Për vitin 2026, të ardhurat nga qiratë e banesave me qëllim social planifikohen në vlerën **8,596,908 lekë**. Ky parashikim është përgatitur nga Njësia e Menaxhimit të Banësive me Qëllim Social dhe ndahet në detajet si më poshtë:

Nr	Banesa sociale CEB	Nr. Ap	Qira mujore	Qira vjetore	Debitorë	Totali
1	Banesa Nr.1	40	287,961	3,455,532	45,000	3,500,532
2	Banesa Nr.2	29	209,199	2,510,388		2,510,388
3	Banesa Nr.3	29	215,499	2,585,988		2,585,988
Total		98	712,659	8,551,908	45,000	8,596,908

29.TË ARDHURA NGA BANESA TË TJERA NË PRONËSI TË BASHKISË, BANESA SHTETËRORE

Për vitin 2026, parashikohen të ardhura në shumën **54,000 lekë** nga shfrytëzimi i **188 banesave shtetërore** në pronësi të Bashkisë. Ky parashikim është hartuar dhe propozuar nga **Njësia e Menaxhimit të Banësive me Qëllim Social**, duke pasur parasysh të ardhurat historike dhe planin e menaxhimit të fondeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

30.TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESA NË PRONËSI TË BASHKISË ENTI I BANESAVE)

Për vitin 2026, të ardhurat nga qiratë e banesave në pronësi të Bashkisë së E.K.B planifikohen në shumën **2,226,158 lekë**. Ky parashikim është përgatitur nga **Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social** dhe përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

1. **Qira banesash në pronësi të Bashkisë** – të ardhura nga 7 apartamente të dorëzuara nga E.K.B, me një vlerë totale vjetore prej **168,000 lekë**.
2. **Të ardhura nga privatizimi i banesave sociale** – për banesat e dorëzuara nga E.K.B, me një vlerë vjetore prej **2,038,158 lekë**.
3. **Debitorë** – të ardhura nga banesat në pronësi të Bashkisë të dorëzuara nga E.K.B, në shumën **20,000 lekë**.

31.KAMATË VONESA

Kmatë-vonesa për pagesat e vonuara të qirave për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **300,000 lekë**. Ky parashikim është hartuar nga **Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social**, duke u bazuar në trendet e viteve të mëparshme dhe në ecurinë e detyrimeve të prapambetura të qiramarrësve.

32.TARIFË PER DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE

Tarifa për depozitimin e mbetjeve inerte për vitin 2026 është planifikuar në vlerën **5,100,000 lekë**. Planifikimi është kryer nga **Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit**, bazuar në të dhënat e disponueshme dhe trendet e viteve të mëparshme, të lidhura me lejet e ndërtimit, konkretisht për zërin **“Gërmime dhe transport dherash dhe mbetjesh ndërtimore”**. Vlerësimi reflekton trendin e pritur të volumit të punimeve ndërtimore dhe sasinë e mbetjeve inerte që parashikohet të depozitohen gjatë vitit 2026.

33.TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SISTEMIT KULLUES

Tarifa vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues për vitin 2026 është planifikuar në masën **27,997,375 lekë**, duke përfaqësuar **2.3% të totalit të taksave dhe tarifave vendore** të parashikuara për vitin 2026 dhe **5.9% të totalit të të ardhurave të planifikuara vetëm nga tarifat vendore**.

Ky parashikim është hartuar mbi një analizë të detajuar, të zhvilluar për matjen dhe identifikimin e sipërfaqeve të tokave bujqësore që përfitojnë nga rrjeti i kanaleve kulluese dhe rrugëve të parcelave. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë të gjitha informacionet zyrtare të siguruar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, lidhur me kostot reale të operacioneve të mirëmbajtjes dhe shërbimeve në terren.

Ky planifikim pasqyron shpenzimet dhe nevojat për:

- Pastrimin dhe funksionalizimin e rrjetit të kanaleve të kullimit;
- Mirëmbajtjen e rrugëve të parcelave dhe çakullimin e tyre;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- Vendosjen dhe riparimin e tombinove;
- Çdo shërbim tjetër mbështetës që kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në funksion të rritjes së cilësisë së infrastrukturës bujqësore.

Këto shërbime janë jetike për garantimin e aksesueshmërisë në parcelat bujqësore, uljen e riskut të përmytjeve, rritjen e produktivitetit dhe krijimin e kushteve optimale për aktivitetin bujqësor.

Planifikimi vjetor është ndërtuar mbi dy komponentë kryesorë:

1. Parashikimi i të ardhurave për vitin 2026

Ky parashikim është llogaritur mbi sipërfaqen totale prej 104,480 dynym tokë bujqësore, për të cilat bashkia ofron shërbim të drejtpërdrejtë në infrastrukturën kulluese dhe rrugët e parcelave.

Vlera e parashikuar: 12,618,150 lekë.

2. Detyrimet debitoare të prapambetura

Gjatë viteve të kaluara, një pjesë e zotëruesve të tokave bujqësore kanë akumuluar detyrime të papaguara, të cilat vijojnë të përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave potenciale.

Vlera e detyrimeve debitoare: 15,379,225 lekë

Në përfundim, parashikimi prej **27,997,375 lekë** synon të sigurojë burimet e nevojshme për garantimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të infrastrukturës bujqësore, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës për fermerët, rritjen e sigurisë së prodhimit dhe funksionimin optimal të sistemit kullues e rrugor brenda zonave të kultivimit.

TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA

Të ardhurat nga taksat e ndara përbëjnë një kategori të rëndësishme të burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, pasi ato reflektojnë pjesën që i transferohet bashkisë nga taksa kombëtare sipas përcaktimeve ligjore. Për vitin 2026, këto të ardhura zënë **11.2%** të totalit të të ardhurave të planifikuara, duke u konsideruar një burim plotësues, por i qëndrueshëm, i cili ndikon drejtpërdrejt në aftësinë financiare të bashkisë për të garantuar shërbimet publike dhe për të mbështetur investimet kapitale.

C	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	Realizim 2023	Realizim 2024	Plani 2025	Realiz.11 muaj 2025	I pritshëm 2025	Plani 2026
1	TATIM SHITJEJE PASURI E PALUAJTSHME	6,197,114	7,634,433	15,000,000	12,689,009	13,566,279	26,000,000
2	TAKSË RREGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	46,259,021	51,043,386	55,000,000	49,986,487	54,026,811	60,000,000
3	RENTA MINERARE	492,865	275,079	400,000	169,570	180,751	300,000
4	TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE	31,840,118	35,574,204	45,000,000	32,834,373	40,834,373	49,000,000
	TOTALI C	84,789,118	94,527,102	115,400,000	95,679,439	108,608,214	135,300,000

Analiza e strukturës së taksave të ndara tregon se pesha kryesore mbështetet tek tre kategori:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- **Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve,**
- **Tatimi mbi të ardhurat personale,**
- **Tatim-shitja e pasurive të paluajtshme.**

Këto tre burime së bashku sigurojnë mbi **99.8%** të totalit të taksave të ndara, duke përfaqësuar bërthamen e kontributit financiar që mbështet buxhetin vendor. Dominimi i tyre në strukturën e të ardhurave tregon rolin thelbësor që taksat e ndara kanë në sigurinë fiskale të bashkisë dhe rëndësinë e tyre në formulimin e politikave financiare në planifikim.

Më konkretisht po i detajojmë më poshtë:

1.TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	11,999	13,295	17,223	17,176	16,895	16,958	17,021
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	10,282	11,399	14,758	14,711	14,465	14,518	14,573
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,717	1,896	2,465	2,465	2,430	2,439	2,449
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	13,730	18,260	54,714	60,544	49,797	50,722	50,807
602	Mallra dhe sherbime te tjera	13,682	18,260	49,714	56,310	44,277	45,202	45,287
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	5,000	4,186	5,520	5,520	5,520
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	48	0	0	48	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	25,105	32,732	8,740	55,179	13,190	12,000	13,000
230	Shpenzime per ritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per ritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	25,105	32,732	8,740	55,179	13,190	12,000	13,000
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0	0	0	0
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	0	0	0	0	0	0	0
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0	7,875	0	0	0
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	0	0	7,875	0	0	0

Dokumenti Përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 - Miratuar nga Këshilli i NJVQV (Faza III).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË**Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik**

NJVQV: 122 - Bashkia Korçë

Programi: AC122 - Mbështetja për Zhvillim Ekonomik Vendor

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	9,118	0	0	0
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	0	0	0	9,118	0	0	0
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	50,833	64,286	80,677	149,892	79,882	79,680	80,828

Dokumenti Përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 - Miratuar nga Këshilli i NJVQV (Faza III).

Aktivitetet e përfshira në këtë program paraqiten si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Nr.	Emri i projektit	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Korça Snow Fest	500,000	
2	Promovimi i Lara Colturi imazh i turizmit	3,000,000	4,320,000
3	365 dite turizëm "Hakathone"	0	500,000
4	Kopshtet komunitare	0	350,000
5	Çelja e Sezonit turistik në Korçë	0	500,000
6	Balkan Fest / Spirit of Balkan	1,500,000	2,000,000
7	Vargjet që këndojnë (Rozana Radi)	500,000	
8	Rock Festival	3,000,000	3,000,000
9	Spring Festival/ Spring Festival & Pottery Fair	1,500,000	1,630,000
10	Festa e Lakrorit	500,000	
11	Lumina Electronic Festival	3,000,000	1,000,000
12	Christmas & Lights Festival	3,000,000	3,000,000
13	Festivali i Serenatës/ Korça Serenights Festival	3,000,000	3,000,000
14	Fly Korça (Aeronautika Shqiptare)/ Korça Open Air (Aeronautika Shqiptare)	870,000	1,200,000
15	Festa e Mollës	500,000	
16	Festa e Bulgarecit	300,000	
17	Festa e Dardhës	0	0
18	Rrëfenja fshati- panairë me produkte autentike (Voskopoja; Polena; Boboshtica, Dardha, Bulgareci, Vithkuqi; Dvoran)	0	1,400,000
19	Korça Food & Drink	0	2,000,000
20	Panairi i Vjeshtës	0	2,000,000
	TOTALI (Lekë)	21,170,000	25,900,000

Promovimi i Lara Colturi, imazh i Turizmit 2026

Projekti synon promovimin e Korçës si destinacion kryesor turistik në Shqipëri, duke përdorur Lara Colturi, skiatoren e njohur ndërkombëtarisht që ka përfaqësuar Shqipërinë në Kupën e Botës si figurë qendrore të fushatës së marketingut turistik. Korça ka potencial natyror të jashtëzakonshëm për t'u pozicionuar si destinacion i rëndësishëm i turizmit malor falë zonave turistike të veçanta si Dardha, Voskopoja, Boboshtica dhe Vithkuqi. Ky projekt të rrisë dukshmërinë e këtij potenciali në tregjet vendase dhe ndërkombëtare. Fushata promionale, e cila përfshin video profesionale me imazhin e Lara Colturi, me tematike promovimin e turizmit në Korçë si edhe disa reels cilësore gjatë vitit do të pozicionojë Korçën si destinacion 4-sezonal, me fokus të veçantë të sportet e bores, natyrës alpine dhe turizmit të aventurës. Promovimi i Korçës përmes imazhit të Lara Colturi si imazh i turizmit 2026 e pozicionon Korçën jo vetëm si një qendër për ski dhe aventurë, por edhe një markë me identitet të fortë dhe një prej destinacioneve më të rëndësishëm të Shqipërisë.

Kostoja totale shkon 4,320,000 lekë

"365 ditë turizëm" HAKATHONE



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA KORÇË

Projekti zbatohet përmes një programi 12-mujor pilot në të gjithë rajonin e Korçës (Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Pustec, Maliq). Ai kombinon zhvillimin e produkteve turistike, trajnimin e të rinjve dhe ndërtimin e partneriteteve midis sektorit publik dhe privat. Kostoja totale shkon 500,000 lekë

Kopshtet Komunitare

Projekti “Kopshtet Komunitare në Korçë” synon krijimin e hapësirave të gjelbra të përbashkëta në lagje të ndryshme të qytetit, ku banorët mund të kultivojnë fruta, perime, bimë aromatike dhe lule. Kopshtet do të funksionojnë si qendra sociale, edukative dhe mjedisore, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet komunitetit, rritjen e ndërgjegjësimit për qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në qytet. Kostoja totale shkon 350,000 lekë

Panairi i Vjeshtës

Panairi i Vjeshtës në Korçë është një aktivitet festiv, kulturor dhe promovues që organizohet në vjeshtë me qëllim kryesor prezantimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore, agro-ushqimore dhe artizanale të zonës së Korçës, si edhe për të festuar stinën e vjeshtës dhe pasuritë e saj natyrore, gastronomike dhe artizanale. Ky event mbledh së bashku prodhues lokalë, artizanë, biznese turistike, artistë dhe vizitorë nga e gjithë Shqipëria, duke ofruar një atmosferë tipike korçare me ngjyra, muzikë, ushqim tradicional dhe aktivitete familjare. Panairi shërben si një platformë për promovimin e produkteve të sezonit të vjeshtës: mollë, kunguj, verë, reçel, mjaltë, arra, produkte pyjore, gatime tradicionale, si dhe punime artizanale karakteristike të zonës. Aktiviteti kombinohet me koncerte, performanca dhe aktivitete edukative, duke e bërë Korçën një destinacion tërheqës edhe gjatë stinës së vjeshtës.

Kostoja totale shkon 2,000,000 lekë

Çelja e Sezonit Turistik në Korçë

“Çelja e Sezonit Turistik në Korçë” është një aktivitet festiv, kulturor dhe promovues i organizuar për të shënuar fillimin zyrtar të sezonit turistik veror në qytetin e Korçës dhe destinacionet turistike përreth. Projekti përfshin organizimin e një eventi qendror dhe një sërë aktiviteteve shoqëruese që synojnë të prezantojnë ofertën turistike të zonës: kulturën, gastronominë, traditat, artizanatin, historinë, muzikën dhe atraksionet natyrore. Ky event shërben si pikënisje për kalendarin vjetor të aktiviteteve të verës, duke tërhequr vizitorë vendas dhe të huaj, duke promovuar bizneset lokale dhe duke pozicionuar Korçën si një destinacion tërheqës, të gjallë dhe mikpritës.

Kostoja totale shkon 500,000 lekë

“RRËFENJA FSHATI”- Panair me produkte autentike (VOSKOPOJA; POLENA; BOBOSHTICA, DARDHA, BULGARECI, VITHKUQI; DVORAN)

“Rrëfenja Fshati – Panair me Produkte Autentike” është një nismë kulturore dhe agroturistike që synon të promovojë fshatrat me identitet të fuqishëm historik, kulinar dhe artizanal të zonës së Korçës. Projekti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

konsiston në organizimin e një serie panairesh tematikë në shtatë destinacione rurale, duke i shoqëruar me artistë, personalitete të njohura dhe influencer me origjinë nga Korça, të cilët do të sjellin më shumë vizibilitet, emocion dhe histori njerëzore. Ky format synon të ringjallë traditat, të nxisë turizmin rural dhe të forcojë ekonominë lokale përmes promovimit të produkteve autentike, artizanatit, gatimeve tradicionale dhe mikpritjes së fshatrave.

Kostoja totale e këtij projekti shkon 1,400,000 lekë

SPIRIT OF BALKAN

Aktiviteti Spirit of Balkan është një ngjarje ndërkulturor unike që synon të sjellë së bashku kulturat e pasura dhe të larmishme të vendeve të Ballkanit, duke e kthyer Korçën në një qendër për bashkëpunimin rajonal dhe dialogun kulturor. Festivali do të jetë një platformë për të prezantuar traditat më të mira të rajonit përmes muzikës, vallëzimit, artizanatit dhe gastronomisë, duke krijuar një përvojë të jashtëzakonshme për pjesëmarrësit dhe vizitorët. Ky aktivitet do të ndihmojë në promovimin e diversitetit kulturor si një pasuri e përbashkët e Ballkanit dhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore që i bashkon vendet e këtij rajoni historik.

Në zemër të festivalit qëndron ideja e ndërveprimit kulturor, duke sjellë artistë, artizanë, muzikantë dhe sipërmarrës nga vende të ndryshme të Ballkanit për të shkëmbyer ide dhe përvoja. Përmes një programi të pasur dhe të larmishëm aktivitetesh, Spirit of Balkan synon jo vetëm të argëtojë, por edhe të edukojë publikun mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe rolin e saj në ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme ndërmjet komuniteteve. Festivali do të përfshijë aktivitete të shumta, duke filluar nga koncerte muzikore me artistë të njohur dhe grupe tradicionale, deri tek ekspozita artizanale që nxjerrin në pah mjeshtërinë dhe kreativitetin e komuniteteve lokale dhe rajonale. Aktiviteti synon gjithashtu të ketë një ndikim afatgjatë në zhvillimin e turizmit kulturor në Korçë, duke e shndërruar këtë festival në një ngjarje të përvitshme që tërheq turistë vendas dhe ndërkombëtarë. Përmes pjesëmarrjes së artistëve dhe grupeve nga vende të ndryshme, festivali do të krijojë lidhje të reja kulturore dhe ekonomike, duke mbështetur zhvillimin lokal dhe rajonal.

Kostoja totale shkon 2,000,000 lekë

ROCK FESTIVAL

Bashkia Korçë prej më shumë se 3 vjetësh organizon në qendër të qytetit me grupe motoristësh nga disa vende të rajonit aktivitetin që ofron plot emocione dhe spektakël me muzikë rock. Aktiviteti organizohet me pjesëmarrjen e mbi 500 pjesëmarrësve nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, Greqia, etj, të cilët kanë realizuar aktivitete në vende të ndryshme të Shqipërisë. Parada e motoristëve vendas e të huaj shoqërohet me një festival të mirëfilltë të muzikës rock të organizuar në qendër të qytetit të Korçës, për të tërhequr vizitorë të shumtë vendas dhe të huaj. Eventu gjithashtu kënaq shijet e të apasionuarve pas mjeteve motorike, të cilët bëjnë parakalime jo vetëm në qytet, por edhe në destinacionet më të bukura rreth Korçës dhe ekspozohen në qendër të qytetit gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit muzikor me këngë rock.

Kostoja totale shkon 3,000,000 lekë

SPRING FESTIVAL & POTTERY FAIR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Pranvera vjen në Korçë me një larmi aktivitete dhe një dekor të veçantë në qendër të qytetit të Korçës, duke hapur kështu edhe sezonin e festave që kulmojnë më pas me Festivalin Ndërkombëtar të Karnavaleve. Përgjatë gjithë pranverës në Korçë do të ketë aktivitete të ndryshme festive, të listuara në kalendarin e festive të Spring Festival, ku nuk do të mungojnë koncertet në pikat kryesore të qytetit përfshi Zonën Këmbësore por edhe Pazarin e Vjetër, si edhe panairët e ndryshme të prodhimeve artizanale dhe jo vetëm. Kjo periudhë përkon edhe me organizimin e Panairit të Poçerisë në qendër të qytetit të Korçës si edhe festimet e Pashkës Ortodokse, e cila shënon një periudhë me fluks të shtuar vizitorësh në qytet.

Kostoja totale shkon 1.630,000 lekë

KORÇA FOOD & DRINK

Aktiviteti Food & Drink është zgjedhja ideale për të promovuar dhe shitur në bashkëpunim me bizneset produktet (ushqim dhe pije) në zemër të Korçës, gjatë vitit 2026. Përmes këtij aktiviteti, vizitorët vendas dhe të huaj kanë mundësi të degustojnë produktet nga kompanitë pjesëmarrëse, të cilat kanë mundësi të promovojnë markën e tyre, përballë mijëra vizitorëve, në një atmosferë plot aromë dhe shije korçe.

Kostoja totale shkon 2,000,000 lekë

LUMINA ELECTRONIC FESTIVAL

Për herë të dytë në Korçë vjen aktiviteti që ndërthur muzikën me teknologjinë, trendin e kohëve moderne që ka për qëllim promovimin e muzikës elektronike. Në të gjithë botën evente të kësaj natyre janë padyshim një element që tërheq miliona vizitorë të cilët rezevojnë shumë kohë përpara pjesëmarrjen në event. Korça Electronic Beat synon të realizojë një festival të madh të muzikës elektronike, me pjesëmarrjen e DJ më të njohur, i cili përfshin shfaqjet e veçanta me projeksione dhe efekte speciale dritash shumëngjyrëshe, fishekzjarre e surpriza të tjera. Eventit synon të ndërthurë elementë të traditës në rrugicat e ballkonet karakteristike të Korçës për ta kulmuar me performancat muzikore më të bukura tekno nga DJ profesionistë. Eventit do të bashkojë interpretues të ndryshëm muzikorë, të cilët do të impresionojnë të gjithë me stilin dhe muzikën e realizuar deri në orët e vona të mbrëmjes. Kostoja totale shkon 1,000,000 lekë

CHRISTMAS & LIGHTS FESTIVAL

Korça është qyteti i parë që ideoi Panairin e Fundvitit dhe Festivalin e Dritave, me qëllim krijimin e atmosferës festive jo vetëm për banorët e saj, por edhe për tërheqjen e vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët vijnë për t'u argëtuar dhe për të festuar fundvitin në Korçë. Çdo vit që nga festat e nëntorit e deri ditët e para të janarit hotelet e Korçës janë të rezervuara. Muaji dhjetor rezulton nga të jetë më i frekuentuari, çka do të thotë se të gjitha hotelet dhe bujtinat që operojnë në qytet dhe në fshat janë rezervuar muaj më parë, duke e bërë Korçën destinacionin turistik më të preferuar nga vizitorët vendas dhe të huaj. Larmi aktivitete do të ketë gjatë gjithë muajit dhjetor. Përmendim Marketin i Bredhave natyralë, i vendosur sheshi para Katedrales "Ringjallja e Krishtit", ku të gjithë kanë mundësi të zgjedhin pemën natyrale të Krishtlindjes për të dekoruar dhe për të krijuar atmosferë festive në shtëpitë gjatë festimeve të Krishtlindjes dhe Vitit të Ri. Christmas Market në qendër të qytetit është vendi fantastik për



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

blerjet tuaja të Krishtlindjes. Të gjithë mund të shijojnë aromën e rakisë së pjekur, gështenjave dhe produkteve lokale në argëtimin pafund që ofron Pista e Patinazhit. Vendi ideal ku të gjithë mund të blejnë dhurata fantastike, për t'i vendosur nën pemën e Krishtlindjes, ose për t'ua dhuruar të afërmeve dhe miqve. Nuk do të mungojnë lojërat dhe aktivitetet argëtuese për fëmijët si edhe spektakli i fishekzjarreve në mbrëmjen e ndërrimit të viteve në qendër të qytetit, i cili nuk duhet humbur. Të gjitha eventet e muajit dhjetor 2026 do të kulmojnë me performancat muzikore live, koncerte nga grupe e banda muzikore si edhe street party me DJ më të njohur në një prej destinacioneve më atraktive dhe turistike siç janë “Pazari i Vjetër” i Korçës dhe Zona Këmbësore, zona tepër të frekuentuara nga vizitorët gjatë periudhës së festave të fundvitit.

Kostoja totale shkon 3,000,000 lekë

KORÇA SERENIGHTS FESTIVAL

Korça Serenights Festival (Festivali i Serenatës) është një aktivitet për kulturën e serenatës, një traditë muzikore që ka zanafillën në periudhën osmane dhe ka një lidhje të thellë me historinë dhe kulturën e qytetit. Gjatë këtij festivali, artistët dhe grupet muzikore përformojnë serenata tradicionale dhe moderne, duke krijuar një atmosferë romantike dhe magjike që mbush çdo kënd të qytetit. Festivali zhvillohet në vendet më karakteristike të Korçës, si Pazari i Vjetër, që i japin festivali një nuancë unike të historisë dhe kulturës lokale. Ky festival ofron një mundësi të shkëlqyer për turistët dhe vizitorët që të shijojnë muzikën dhe atmosferën e veçantë të serenatës, të njohin traditat e qytetit dhe të angazhohen në aktivitete kulturore që pasurojnë përvojën e tyre. Përveç muzikës, Festivali i Serenatës përfshin edhe emra të muzikës të huaj, që përngjasojnë me serenatat e Korçës si serenatat e Spanjës etj, duke e bërë atë një event të pasur kulturore që promovon trashëgiminë dhe lidhjet e saj me muzikën dhe artin. Kostoja totale shkon 3,000,000 lekë

KORÇA OPEN AIR (Mbështetje për Federatën Shqiptare të Aeronautikës)

“Korça Open Air” është një aktivitet i përvitshëm kulturor-sportiv i zhvilluar në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Aeronautikës te Fusha e Fluturimit dhe Terrenit (ish Fusha e Aviacionit), Lumalas, një hapësirë ideale për aktivitete të mëdha në natyrë dhe demonstrime ajrore. Eventi kombinon muzikën, gatimet e pijet tradicionale dhe shfaqjet aeronautike (paragliding, paramotor, fluturime të sinkronizuara), duke ofruar një përvojë unike për vizitorë vendas dhe të huaj. Përveç garave të precizionit, ku pilotët konkurruan për saktësi në fluturim dhe ulje të kontrolluara, risi e edicionit të vitit 2025 ishte edhe aeromodeling për fëmijët te Qyteza e Fëmijëve, ku fëmijët mësuan të ndërtojnë avione prej letre, për t'u argëtuar dhe garuar mes tyre, me synimin që t'i afrojë të vegjëlit me botën e fluturimeve përmes lojës dhe ndërtimit të avionëve prej letre në miniaturë. Ky aktivitet është një aktivitet sportiv dhe spektakolar që zhvillohet çdo vit në qytetin e Korçës, duke rritur kështu jo vetëm cilësinë e organizimit të aktivitetit sportiv, por gjithashtu promovon tek pjesëmarrësit Korçën si një destinacion të preferuar turistik gjithëvjetor, ku organizohen aktivitete të ndryshme. Kostoja

totale e këtij projekti shkon 1,200,000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Tabela e detajuar e projekteve në fushën e inovacionit, të cilat do të menaxhohen nga Bashkia dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Cerdhes.

/lekë

NR	EMRI I PROJEKTTIT	BUXHET 2025	BUXHET 2026	PROGRAMI
1	Trajnime ne fushen e Inovacionit per sipermarrjes te rinj	3,060,000	1,800,000	Mbështetje e zhvillimit ekonomik
2	Koduesit e Rinj	6,000,000	4,200,000	Arsimi bazë parashkollor NSHMAC
3	Korca ICT Academy	3,000,000	3,000,000	Arsimi bazë parashkollor NSHMAC
4	Klubet e Ict ne shkolla	6,200,000	6,200,000	Arsimi bazë parashkollor NSHMAC
5	Promovim dixhital	1,200,000	1,200,000	Arsimi bazë parashkollor NSHMAC
6	Kontribut per projektin e inovacionit	5,000,000	-	Mbështetje e zhvillimit ekonomik
7	Hacathon " Korca Innovate"	-	900,000	Mbështetje e zhvillimit ekonomik
8	AI Challenge Korca- Hacathon i Talenteve	-	1,200,000	Mbështetje e zhvillimit ekonomik
9	AI Creators Fest	-	1,000,000	Mbështetje e zhvillimit ekonomik
10	AI Future Korca	-	800,000	Mbështetje e zhvillimit ekonomik
11	InnoKids Camp	-	800,000	Arsimi bazë parashkollor NSHMAC
TOTALI		24,460,000	21,100,000	

Trajnime në fushën e Inovacionit për sipërmarrës të rinj

Programe trajnimi për aftësim profesional të të rinjve mbi 16 vjeç, të orientuara drejt zhvillimit të aftësive digjitale dhe kompetencave soft skills. Trajnimet përfshijnë fusha bashkëkohore si Inteligjenca Artificiale, Digital Marketing, SEO, Graphic Design, Social Media Management, LinkedIn Marketing, etj. Këto programe kanë për qëllim përmirësimin e aftësive profesionale, rritjen e mundësive për punësim dhe përgatitjen e të rinjve për kërkesat e tregut modern të punës.

Koduesit e Rinj

Trajnime në fushën e teknologjisë dhe inovacionit për fëmijë dhe të rinj të moshës 7–15 vjeç, duke përfshirë: kodim (Scratch & Python), robotikë, Java, ëeb design, graphic design, modelim 3D, inteligjencë artificiale bazë, VR dhe sipërmarrje kreative. Fëmijë të grupmoshave të ndryshme marrin pjesë në këto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

programe të vazhdueshme gjatë 12 muajve, duke zhvilluar aftësi digjitale, logjike dhe krijuese për profesionet e së ardhmes.

Korça ICT Academy

Korça ICT Academy është një program veror edukativ në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, i dedikuar për të rinjtë e moshës 15–18 vjeç. Akademia zhvillohet në bashkëpunim me mentorë nga Universiteti Stanford dhe profesionistë të diasporës shqiptare në Silicon Valley, duke ofruar një përvojë unike mësimore. Programi përfshin trajnime në Python, zhvillim ëeb, bazat e inteligjencës artificiale dhe Human-Centered Design, të kombinuara me punë praktike në grup. Përmes zhvillimit të projekteve reale me ndikim në komunitet, pjesëmarrësit forcojnë aftësi kyçe si mendimi kritik, lidhshipi, prezantimi dhe bashkëpunimi në ekip. Korça ICT Academy synon të fuqizojë të rinjtë si gjenerata e ardhshme e inovatorëve dhe krijuesve të teknologjisë në Shqipëri.

Klubet e Ict në shkolla

Klubet e ICT në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme përbëjnë një iniciativë edukative gjithëpërfshirëse që përfshin mbi 450 nxënës nga më shumë se 10 shkolla të Bashkisë Korçë. Përmes aktiviteteve interaktive si sfida teknologjike, mini-hackathon-e dhe projekte praktike, nxënësit aftësohen në fusha si programimi, robotika, ëeb design, intelijenca artificiale dhe sipërmarrja digjitale.

Kjo nismë nxit kreativitetin, mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve reale të komunitetit, duke i orientuar të rinjtë drejt përdorimit të teknologjisë si mjet për inovacion dhe zhvillim. Programi luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e brezit të ri të profesionistëve të TIK-ut dhe në ndërtimin e liderëve të ardhshëm të transformimit digjital në qytet.

Promovim dixhital

Buxheti i parashikuar për promovimin digjital synon mbështetjen e fushatave online për promovimin e aktiviteteve, trajnimeve dhe nismave të ndryshme të zhvilluara. Përmes përdorimit të platformave digjitale dhe rrjeteve sociale, këto fushata synojnë të informojnë dhe të angazhojnë një audiencë sa më të gjerë, duke rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit.

Fokusi i promovimit digjital është rritja e dukshmërisë së aktiviteteve, përmirësimi i komunikimit me publikun dhe krijimi i një ndërveprimi të vazhdueshëm me të rinjtë, prindërit, institucionet dhe aktorët e tjerë të interesuar. Në këtë mënyrë, promovimi digjital kontribuon në forcimin e imazhit të nismave dhe në rritjen e ndikimit të tyre në nivel lokal.

Hacathon " Korça Innovate"

Hackathon "Korçë Innovate" është një maratonë disa ditore që mbledh të rinj, programues, studente UNIKO dhe dizenjues nga Korça dhe qytete të tjera të Shqipërisë, për të zhvilluar ide dhe zgjidhje inovative për sfidat lokale në turizëm, mjedis dhe edukim. Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit njihen me nevojat e bizneseve lokale dhe punojnë në ekipe për të krijuar zgjidhje konkrete. Në fund, projektet prezantohen përpara një jurie dhe përfaqësuesve të bizneseve, të cilët mund të ofrojnë bashkëpunime, kontrata pune dhe mbështetje për zhvillimin e ideve. Ky hackathon forcon lidhjen midis të rinjve dhe sektorit privat, duke nxitur inovacionin dhe punësimin në Korçë.

AI Challenge Korça- Hacathon i Talenteve

Hackathon "Korçë Innovate" është një maratonë disa ditore që mbledh të rinj, programues, studente UNIKO dhe dizenjues nga Korça dhe qytete të tjera të Shqipërisë, për të zhvilluar ide dhe zgjidhje inovative për sfidat lokale në turizëm, mjedis dhe edukim. Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit njihen me nevojat e



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

bizneseve lokale dhe punojnë në ekipe për të krijuar zgjidhje konkrete. Në fund, projektet prezantohen përpara një jurie dhe përfaqësuesve të bizneseve, të cilët mund të ofrojnë bashkëpunime, kontrata pune dhe mbështetje për zhvillimin e ideve. Ky hackathon forcon lidhjen midis të rinjve dhe sektorit privat, duke nxitur inovacionin dhe punësimin në Korçë.

AI Challenge Korca- Hacathon i Talenteve

Aktivizon të rinjtë, studentët UNIKO dhe startup-et për të zhvilluar zgjidhje teknologjike praktike me AI. Pjesëmarrësit punojnë në ekipe për të krijuar projekte inovative që adresojnë sfida reale për komunitetin (turizem, mjedis, transporti, energjia etj) me mbështetje nga mentorë dhe profesionistë të fushës.

AI Creators Fest

Një event krijues që eksploron mundësitë e AI në art, muzikë, dizajn dhe media digjitale.

Eventi bashkon artistë, krijues dhe teknologë për të demonstruar sesi inteligjenca artificiale mund të shndërrohet në një mjet të ri krijimtarie dhe ekspresiviteti.

AI Future Korca

AI Future Korça” do të jetë festival përmbyllës vjetor i nismës “AI Korça 360° – Inovacion, Kreativitet, Biznes”, duke bashkuar në një event të vetëm ekspertë të teknologjisë, studentë, startup-e dhe biznese lokale që kanë qenë pjesë e aktiviteteve “AI Challenge Korça”, “AI Creators Fest” dhe “AI for Business & Startups”.

Ky festival do të shërbejë si platformë prezantimi, diskutimi dhe rrjetëzimi, ku do të ekspozohen projektet më të mira, idetë fituese dhe produktet e zhvilluara me AI gjatë vitit. Konferencë kryesore: Prezantime nga ekspertë kombëtarë e ndërkombëtarë mbi ndikimin e AI në arsim, ekonomi dhe jetën e përditshme.

Demonstrime live: Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të shohin përdorime reale të AI në dizajn, biznes, turizëm dhe shërbime publike.

Panairi i projekteve: Ekspozitë me stenda të të rinjve, bizneseve dhe startup-eve, që prezantojnë produktet dhe idetë e tyre.

Sesione trajnimi & etike: Mini-ëorkshope mbi përdorimin etik, krijues dhe të sigurt të inteligjencës artificiale.

Ceremonia e mbylljes: Prezantimi i planeve për edicionin e ardhshëm të “AI Korça 360°”

InnoKids Camp

“InnoKids Camp është një kamp veror në fushën e teknologjisë, i cili do të zhvillohet përgjatë një muaji në Bibliotekën e Fëmijëve. Kampi do të ofrojë një program edukativ dhe interaktiv për 50 fëmijë, ku ata do të kenë mundësinë të mësojnë programim, robotikë, dizajn digjital dhe aktivitete kreative të teknologjisë. Pjesëmarrësit do të zhvillojnë aftësi praktike, kreativitet dhe zgjidhje probleme në një ambient të sigurt dhe stimulues.”

8.4. Programi AJ122 Fondi rezervë 04910

Për vitin 2026 fondi i planifikuar do të jetë në vlerën 10,000 mijë lekë,

Për vitin 2027 fondi i planifikuar do të jetë në vlerën 10,000 mijë lekë,

Për vitin 2028 fondi i planifikuar do të jetë në vlerën 10,000 mijë lekë,

Fondi rezervë do të përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të paparashikuara, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Buxheti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

vendor përfshin një fond rezervë, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

8.5. Programi AK122 Fondi i kontigjencës 04940

Për vitin 2026, 2027, 2028 është planifikuar fondi i kontigjencës, në vlerën 10,000 mijë lekë në çdo vit. Buxheti vendor përfshin një fond kontigjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi i kontigjencës është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. Gjithashtu fondi i kontigjencës krijohet për të përballuar edhe efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.

8.6. Programi Mbrojtja e Mjedisit AD122

8.6.1 Vështrim i përgjithshëm

Ky program përfshin mbledhjen, depozitimin e mbeturinave, trajtimin, pastrimin e rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtjen e ajrit dhe e klimës, mbrojtjen e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimin e zhurmave dhe vibracioneve, si dhe mbrojtjen ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore

Buxheti i planifikuar për programin mbrojtja e mjedisit është 207,325 mijë lekë. Buxheti për këtë program jepet si më poshtë:

shpenzime personeli	6,702 mijë lekë
shpenzime korrente	195,623 mijë lekë
shpenzime për investime	5,000 mijë lekë

Pesha specifike që ky program ze, është 8% dhe krahasuar me vitin 2025 ka një ulje prej 4%.

Fondi i planifikuar për paga do të jetë në vlerën 5,741 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 961 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë në vlerën 152,979 mijë lekë, (shërbimi i pastrimit i planifikuar sipas vlerës së kontratës).

Fondi i planifikuar për transfertat tek organizatat do të jetë në vlerën 42,644 mijë lekë, kontributi i bashkisë Korçë për landfillin e mbetjeve KRW. Ky fond do të financohet 7,600 mijë lekë nga transfertat e pakushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve dhe vlera prej 35,044 mijë lekë nga të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore të Bashkisë.

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime do të jetë në vlerën 5,000 mijë

Të gjitha shpenzimet e detajuara sipas llogarive ekonomike, për vitet 2023-2028 paraqitet si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

000/lekë

Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 122 - Bashkia Korçë

Programi: AD122 - Mbrojtja e Mjedisit

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	3,687	4,261	5,435	5,435	6,702	6,836	6,973
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	3,161	3,652	4,658	4,658	5,741	5,856	5,973
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	526	610	778	778	961	980	1,000
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	135,061	185,123	193,385	204,106	195,623	196,000	196,000
602	Mallra dhe sherbime te tjera	102,465	144,858	153,129	153,129	152,979	153,000	153,000
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	32,546	40,265	40,256	50,977	42,644	43,000	43,000
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	50	0	0	0	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	10,000	10,000	5,000	5,000	5,000
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patruazuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te truazuara	0	0	10,000	10,000	5,000	5,000	5,000
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	138,748	189,384	208,820	219,541	207,325	207,836	207,973

Dokumenti Përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 - Miratuar nga Këshilli i NJVQV (Faza III).

8.7. Programi: Shërbime Publike Vendore AE122

8.7.1. Vështrim i përgjithshëm

Ky program siguron ofrimin e shërbimeve publike vendore dhe menaxhohet nga Bashkia dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Buxheti i këtij programi është 784,973 mijë lekë gjithsej dhe fondi që menaxhohet nga Bashkia është në vlerën 158,651 mijë lekë, dhe i detajuar si më poshtë:

shpenzime personeli 2,392 mijë lekë

shpenzime korrente 15,500 mijë lekë

shpenzime për investime 140,759 mijë lekë

Pesha specifike që ky program ze, është 30% dhe krahasuar me vitin 2025 ka një rritje prej 7%.

Fondi i planifikuar për paga do të jetë në vlerën 2,049 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 343 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë në vlerën 5,500 mijë lekë , (fondi i planifikuar për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve)

Fondi i planifikuar për subvencionin për transportin urban do të jetë në vlerën 10,000 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime do të jetë në vlerën 140,759 mijë lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

Të gjitha shpenzimet e detajuara sipas llogarive ekonomike, për vitet 2023-2028 paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 122 - Bashkia Korçë

Programi: AE122 - Shërbimet Publike Vendore

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	255,339	269,876	343,612	342,851	399,064	402,733	406,440
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	218,799	231,278	294,486	293,725	342,035	345,180	348,358
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	36,540	38,598	49,126	49,126	57,029	57,553	58,083
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	204,690	220,354	280,149	295,615	227,130	234,194	234,676
602	Mallra dhe sherbime te tjera	193,797	209,622	270,149	284,959	217,130	224,194	224,676
603	Subvencionet	9,999	9,999	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	894	734	0	656	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	69,391	68,900	117,591	135,500	158,779	183,171	198,800
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	69,391	68,900	117,591	135,500	158,779	183,171	198,800
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	529,420	559,130	741,352	773,966	784,972	820,099	839,916

Dokumenti Përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 - Miratuar nga Këshilli i NJVQV (Faza III).

8.8. Programi: Arsimi Bazë dhe Parashkollor AG122**8.8.1. Vështrim i përgjithshëm**

Ky program përfshin mbështetjen e arsimit bazë dhe parashkollor, administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Buxheti i këtij programi është 540,251, dhe nga Bashkia menaxhohet buxheti në vlerën 47,748 mijë lekë, e planifikuar për shpenzime operative (shpenzime karburanti dhe shpenzime energji, ujë dhe telefon për Shoqërinë e Doktrinës së Krishterë ose shkolla e Maltës), si dhe shpenzimet për organizimin e festës së mësuesit, dhe shpenzime për investime:

Shpenzime korrente 1,600 mijë lekë

Shpenzime për investime 46,148 mijë lekë

Pesha specifike që ky program zë, është 21% dhe krahasuar me vitin 2025 ka një rritje prej 9%.

Të gjitha shpenzimet e detajuara sipas llogarive ekonomike, për vitet 2023-2028 paraqitet si më poshtë:

000/lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 122 - Bashkia Korçë

Programi: AG122 - Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	255,845	280,076	342,087	341,339	382,767	384,294	385,697
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	218,972	239,763	292,079	291,331	327,500	328,796	330,118
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	36,873	40,313	50,008	50,008	55,267	55,498	55,579
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	84,648	105,809	106,123	126,379	108,336	110,471	111,559
602	Mallra dhe sherbime te tjera	75,286	94,380	106,123	125,736	108,336	110,471	111,559
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	1,436	2,754	0	0	0	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	7,925	8,676	0	643	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	17,594	35,729	46,174	46,348	49,148	34,000	40,000
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	17,594	35,729	46,174	46,348	49,148	34,000	40,000
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	358,087	421,614	494,384	514,065	540,251	528,765	537,256

Dokumenti Përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 - Miratuar nga Këshilli i NJVQV (Faza III).

Festa e mësuesit, 7 mars

Bashkia Korçë, organizon çdo vit në datën 7 Mars një pritje për mësuesit pensionistë në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për kontributin, përsuhtimin dhe profesionalizimin e tyre në vite. Në këtë ditë, Kryetari i Bashkisë përcjell urimet dhe falenderimet për kontributin e jashtëzakonshëm të mësuesve korçarë në vite, të cilët kanë edukuar me përkushtim e fisnikëri disa breza nxënësish. Në aktivitet marrin pjesë përfaqësues nga institucionet publike në qytet, përfaqësues të Këshillit të Qarkut Korçë, etj.

Kostoja totale shkon 700,000 lekë

8.9. Programi: Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm AH122

8.9.1. Vështrim i përgjithshëm

Ky program mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit ka në fokus zhvillimin e projekteve për të rinjtë.

Buxheti i këtij programi është 105,167 mijë lekë, dhe buxheti i cili menaxhohet nga Bashkia është në vlerën 24,680 mijë lekë, i detajuar si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

- Shpenzime korrente 180 mijë lekë -
 Shpenzime për investime 24,500 mijë lekë
 Pesha specifike që ky program ze, është 4% dhe krahasuar me vitin 2025 ka një rritje prej 34%.
 Vlera prej 180 mijë lekësh do të përdoret për realizimin e aktiviteteve për të rinjtë Java e Evropës.

Vlera prej 24,500 mijë lekësh do të përdoret për rikonstruksione të objekteve të arsimit të mesëm të përgjithshëm.

Të gjitha shpenzimet e detajuara sipas llogarive ekonomike, për vitet 2023-2028 paraqitet si më poshtë:
 000/lekë

Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 122 - Bashkia Korçë

Programi: AH122 - Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	37,279	39,976	44,807	44,549	50,912	50,912	50,912
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	31,944	34,255	38,400	38,142	43,630	43,630	43,630
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	5,335	5,721	6,407	6,407	7,282	7,282	7,282
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	18,532	21,831	28,210	28,768	29,455	30,680	31,680
602	Mallra dhe sherbime te tjera	14,517	18,646	23,710	24,043	24,955	26,180	27,180
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	4,015	3,185	4,500	4,725	4,500	4,500	4,500
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	35,056	14,807	5,300	5,437	24,800	20,500	25,500
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patruazuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te truazuara	35,056	14,807	5,300	5,437	24,800	20,500	25,500
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	90,867	76,613	78,317	78,754	105,167	102,092	108,092

Dokumenti Përfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxhetit 2026 - Miratuar nga Këshilli i NJVQV (Faza III).

8.10. Programi: Përkujdesi social AI122

8.10.1. Vështrim i përgjithshëm

Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Totali i buxhetit për programin përkujdesi social do të jetë 96,428 mijë lekë, i cili menaxhohet nga Bashkia dhe pjesa tjetër do të menaxhohet nga Qendra Ditore e Zhvillimit, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit dhe Qendra e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, (ish Shtëpia e



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KORÇË

Foshnjës).

Buxheti i cili do të menaxhohet nga Bashkia për vitin 2026 është në vlerën 92,480 mijë lekë, dhe i detajuar si më poshtë:

Pesha specifike që ky program zë, është 4% dhe krahasuar me vitin 2025 ka një rritje prej 17%.

- shpenzime personeli 64,900 mijë lekë
- shpenzime korrente 15,496 mijë lekë
- shpenzime për investime 12,084 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga do të jetë në vlerën 55,615 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 9,285 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë në vlerën 12,851 mijë lekë

Fondi i planifikuar për subvencionin për interesat e kredise do të jetë në vlerën 200 mijë lekë

Fondi i planifikuar për transferta tek individët do të jetë në vlerën 2,445 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime do të jetë në vlerën 12,084 mijë

Të gjitha shpenzimet e detajuara sipas llogarive ekonomike, për vitet 2023-2028 paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Raporti: PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

NJVQV: 122 - Bashkia Korçë

Programi: A1122 - Përkujdesi Social

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	29,082	38,996	57,197	57,276	67,313	68,659	70,033
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	24,918	33,456	49,017	49,063	57,673	58,831	60,010
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	4,164	5,540	8,179	8,212	9,640	9,828	10,022
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	16,167	11,754	14,131	14,504	17,031	17,850	17,987
602	Mallra dhe sherbime te tjera	10,039	9,571	11,306	11,679	14,386	15,205	15,342
603	Subvencionet	628	202	700	700	200	200	200
604	Transferime korrente te brendeshme	4,000	0	0	0	0	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	1,501	1,981	2,125	2,125	2,445	2,445	2,445
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	3,594	8,419	11,218	11,218	12,084	12,500	12,500
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	3,594	8,419	11,218	11,218	12,084	12,500	12,500
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	48,843	59,169	82,546	82,997	96,428	99,009	100,519



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Aktivitetet e planifikuara në këtë program paraqiten si më poshtë:

Titulli i aktivitetit	Fondi i planifikuar 2025	Fondi i planifikuar 2026
20 Nëntori "Dita e të drejtave të fëmijëve"	97,000	97,000
"Fondi Social për rastet emergjente"	150,000	350,000
"Kampi veror"	1,202,200	1,500,000
8 Prilli "Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Rom"	69,200	63,800
Qendra ditore për fëmijë – Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë	1,770,000	1,770,000
24 Qershor "Dita e Egjiptianëve të Ballkanit"	92,000	35,000
Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e barazisë gjinore në shoqëri	83,000	82,900
Qendër Komunitare për moshën e tretë	3,330,000	3,330,000
3 Dhjetor "Dita Ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara"	-	57,000
Fushatë ndërgjegjësimi mbi 16 ditët e aktivizimit të dhunës me bazë gjinore	226,000	181,000
Kite shkollore	432,500	432,500
Aktivitet promovues në ambjentet e Kopshteve Komunitare	270,000	
Strehëza emergjente për rastet e dhunës në familje	252,000	
Dita ndërkombëtare e gruas 8 mars	500,000	300,000
Shkopi I bardhe		20,000
Total	8,473,900	8,219,200

20 Nëntori " Dita e të drejtave të fëmijëve "

Dita e të drejtave të fëmijëve është një aktivitet që organizohet prej disa vitesh me qëllim respektimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Promovimi i idealeve dhe objektivave të Kartës për të Drejtat e Fëmijëve si dhe mirëqenia e fëmijëve të botës.

Kostoja totale 97,000 lekë

"Fond social për rastet emergjente"

Nevoja për mbështetje emergjente me paketa ushqimore për rastet në menaxhim.

Plotësimi i nevojave bazike për rastet që vlerësohen në situatë shumë të vështirë ekonomike dhe sociale.

Këto paketa ushqimore do të përfitohen nga persona të cilët në momentin e vlerësimit nuk kanë asnjë mundësi ekonomike për plotësim nevojash bazike. Plotësimi i nevojave emergjente për kapërcimin e situatës së vështirë social-ekonomike të rasteve në menaxhim.

Kostoja totale 350,000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Kampi veror 2026

Kampi veror është një aktivitet i cili organizohet gjatë muajit korrik ku fëmijët përfshihen në aktivitete të ndryshme mësimore, argëtuese, informuese dhe kulturore me qëllim gjithëpërfshirjen dhe përcjelljen e vlerave qytetare dhe njerëzore.

Krijimi i mundësive për të krijuar hapesira të sigurta për fëmijët ku ata të kenë mundësi të edukohen, të argetohen, të ndërtojnë marrëdhënie të reja me njëri tjetrin në funksion të gjithëpërfshirjes dhe të drejtës për pjesëmarrje aktive. Ka 18 vite që organizohet ky projekt në bashkëpunim me organizata të ndryshme si World Vision, Terre des Homme, Dorcas Aid, Misioni Emanuel, GIZ, SOS, UNDP etj.

Kostoja totale 1,500,000 lekë

8 Prilli “Dita ndërkombëtare e komunitetit rom”

8 Prilli Dita Ndërkombëtare e Romëve – është një ditë me rëndësi të veçantë për të vlerësuar traditat, kulturën dhe historinë e komunitetit rom në mbarë botën. Në qytetin tonë, kjo ditë është një mundësi për të sjellë në vëmendje jo vetëm trashëgiminë kulturore të romëve, por edhe sfidat me të cilat ata përballen, si diskriminimi, përjashtimi social apo paragjykimet. Një ndër mënyrat më të rëndësishme për të luftuar diskriminimin është ndërgjegjësimi i brezave të rinj për barazi, respekt dhe bashkëjetesë pa paragjyime. Këtë vit, aktiviteti do të ketë në qendër edhe tematikën “Një ditë në jetën e një fëmije rom”, përmes së cilës nxënësit do të tregojnë nga përditshmëria e tyre për sfidat që ata hasin, dhe do të reflektojnë mbi sfidat, ëndrrat dhe jetën e tyre të përditshme.

Synimi i kësaj nisme është të ndërgjegjësojë nxënësit për rëndësinë e barazisë, respektit dhe përfshirjes, si dhe t’u japë atyre mundësinë të njihen me kulturën, historinë dhe traditat e komunitetit rom.

